



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 prill 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së
Pashtrikut**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21, 37 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 31 mars, 9 qershor, 27 korrik, 8 gusht, 3 tetor dhe 5 dhjetor 2023, si dhe më 21 dhe 26 shkurt 2025, dhe 4 mars 2025, Trupi Gjykses lëshoi një numër vendimesh në lidhje me mocionet për pranimin e provave jогоjore të dorëzuara prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS").¹

2. Më 18 shkurt 2025, ZPS-ja dorëzoi një mocion për pranimin e dokumenteve të Zonës Operative të Pashtrikut ("Zona Operative e Pashtrikut"), ("Mocioni").²

¹ F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jогоjore*, ("Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore"), 31 mars 2023, konfidencial; F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jогоjore* ("Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore"), 9 qershor 2023; F01705, Trupi Gjykses, *Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jогоjore*, 27 korrik 2023; F01716, Trupi Gjykses, *Vendimi i Katërt mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jогоjore*, 8 gusht 2023, konfidencial; F01832, Trupi Gjykses, *Vendimi i Pestë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jогоjore*, 3 tetor 2023; F01983, Trupi Gjykses, *Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jогоjore* ("Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore"), 5 dhjetor 2023; F02951, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Llapit dhe Kërkesën në lidhje me Të* ("Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore të Zonës së Llapit"), 21 shkurt 2025; F02967, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Drenicës* ("Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jогоjore të Zonës së Drenicës"), 26 shkurt 2025, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F02967/RED); F02980, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut* ("Vendimi në lidhje me Dokumentet e Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut"), 4 mars 2025.

² F02944, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Pashtrikut*, konfidencial, me Shtojcat 1-3, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 21 shkurt 2025, F02944/RED).

3. Më 7 mars 2025, pasi iu miratua kërkesa për zgjatje të afatit të dorëzimit të përgjigjeve,³ Mbrojtja dorëzoi një përgjigje të përbashkët ndaj Mocionit ("Përgjigjja").⁴

4. Më 17 mars 2025, ZPS-ja dorëzoi kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").⁵

II. PARASHTRIME

5. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dokumenteve të asaj kohe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") ("provat materiale të propozuara") në lidhje me Zonën Operative të Pashtrikut. ZPS-ja parashtron se që të gjitha këto dokumente janë *prima facie* autentike, relevante dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.⁶

6. ZPS-ja parashtron se provat materiale të propozuara janë *prima facie* relevante pasi lidhen me pretendime të ndryshme dhe fakte relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë, dhe konfirmojnë dhe plotësojnë dëshmitë e dëshmitarëve, provat e tjera dokumentare dhe faktet e konstatuara në procese të tjera.⁷ ZPS-ja gjithashtu parashtron se provat materiale të propozuara përmbajnë elementë të shumtë autenticiteti, të përshkruara në Shtojcën 1.⁸ ZPS-ja gjithashtu parashtron se provat materiale të propozuara janë relevante, *prima facie* autentike, në të cilat mund të mbështetesh dhe kanë gjithashtu vlerë provuese.⁹

³ Transkripti i seancës, 19 shkurt 2025, f. 25471, rreshti 14 deri në f. 25472, rreshti 2.

⁴ F02991, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Pashtrikut (F02944)*, 7 mars 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁵ F03030, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Mocionin për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Pashtrikut (F02944)*, 17 mars 2025, konfidenciale.

⁶ Mocioni, paragrafët 1, 33, që u referohen Shtojcës 1 të Mocionit, provave materiale të propozuara 1-316.

⁷ Mocioni, para. 26.

⁸ Mocioni, para. 27-30.

⁹ Mocioni, para. 31.

7. Mbrojtja kundërshton pranimin e provave materiale të propozuara sepse:¹⁰ (i) shumë prej provave materiale të propozuara nuk janë *prima facie* autentike, kanë pak ose nuk kanë aspak vlerë provuese dhe atyre u mungojnë *treguesit* e nevojshëm të mbështetshmërisë;¹¹ (ii) ZPS-ja kërkon të shtojë qindra dokumente në dokumentacionin e çështjes gjyqësore i cili edhe tani është i pamenaxhueshëm, çka pengon aftësinë e Mbrojtjes për të bërë parashtrime të njëmendta në lidhje me provat materiale të pranuar në dosjet gjyqësore përfundimtare.¹² Mbrojtja argumenton se nevoja që Trupi Gjyqësor të analizojë hollësisht pranueshmërinë e provave materiale të propozuara është edhe më e rëndësishme në këtë fazë të gjykimit, ku asnjë prej dëshmitarëve të mbetur që ZPS-ja synon të thërrasë nuk ka lidhje me Zonën Operative të Pashtrikut.¹³

8. Mbrojtja mbështetet në të njëjtat kategori kundërshtimesh të formuluar më parë lidhur me mocionet e mëhershme të ZPS-së për pranimin e provave jogojore, dhe argumenton se: (i) Mocioni është i mbushur me dokumente me shkrim dore, të panënshkruara, që nuk kanë datë dhe vulë ose janë përgjithësisht jozyrtare;¹⁴ (ii) ZPS-ja vazhdon që konfirmimin e provave materiale të propozuara ta bëjë me dokumente të tjera të ngjashme, po aq të pambështetshme të paraqitura në Mocion;¹⁵ (iii) në kundërshtim me vendimet e mëparshme të Trupit Gjyqësor në lidhje me këtë aspekt, ZPS-ja e bazon vlerësimin e saj për autenticitetin në materiale provuese që nuk janë pranuar si prova e as janë paraqitur për t'u pranuar si prova;¹⁶ (iv) në provat materiale të propozuara përfshihen

¹⁰ Përgjigjja, para. 2-8, 52. Trupi Gjyqësor mban parasysh kundërshtimet shitesë të paraqitura nga secili ekip i Mbrojtjes në listën e Shtojcës 1 të Përgjigjes, të cilat do t'i trajtojë më poshtë, në kuadër të vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të rregullës 138(1) nga provat materiale të propozuara përkatëse.

¹¹ Përgjigjja, para. 2, 15-19.

¹² Përgjigjja, para. 2, 15.

¹³ Përgjigjja, para. 22, 23, 40.

¹⁴ Përgjigjja, para. 17. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 51; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.12 dhe A.1.4.

¹⁵ Përgjigjja, para. 19-21; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.1, C.1.3, C.12, A.1 A.1.1 A.1.2 A.1.3, A.1.4 A.3 A.3.3 A.3.3.1.

¹⁶ Përgjigjja, para. 21.

“përmbledhje” tejet të gjata materialesh, shpesh pa asnjë lidhje të dallueshme me njëri-tjetrin;¹⁷ (v) ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dokumenteve që dëshmitarët i kanë mohuar, ose që janë sekuestruar në shtëpitë e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja më pas ka zgjedhur t’i heqë nga lista e dëshmitarëve të saj;¹⁸ (vi) ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dokumenteve të cilat nuk u janë treguar asnjëherë dëshmitarëve përkatës gjatë dhënies së dëshmive të tyre para Trupit Gjykses;¹⁹ (vii) ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dokumenteve të cilave dëshmitarët përkatës nuk u kanë konfirmuar autenticitetin, nuk u kanë përcaktuar kontekstin ose nuk i kanë konfirmuar;²⁰ (viii) ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dokumenteve që kundërshtohen nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes gjyqësore;²¹ (ix) pranimi i kaq shumë dokumenteve, të cilat pretendohet se janë relevante për argumentet kryesore të Prokurorisë në këtë fazë të gjykimit, do të dëmtonte Mbrojtjen.²²

9. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Mbrojtja përsërit kundërshtimet e mëparshme të saj ndaj kategorive të gjera të provave, të cilat janë shqyrtuar dhe rrëzuar prej Trupit Gjykses, dhe keqinterpreton e shpërfill argumentet e paraqitura në Mocion.²³ Në veçanti, ZPS-ja parashtro se, në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes, ajo u ka treguar dëshmitarëve dhe ka paraqitur përmes tyre një numër të konsiderueshëm dokumentesh të asaj kohe të UÇK-së që kanë lidhje me Zonën Operative të Pashtrikut dhe këta dëshmitarë sqaruan kontekstin e tyre, bënë komente në lidhje me to dhe/ose konfirmuan autenticitetin e dokumenteve.²⁴ ZPS-ja gjithashtu kundërpërgjigjet se Mbrojtjes iu dha mundësia t’i përdorte provat

¹⁷ Përgjigjja, para. 2; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.1, C.1.3, C.4, C.8, C.11, C.12 dhe C.13.

¹⁸ Përgjigjja, para. 3, 17, 24-32; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

¹⁹ Përgjigjja, para. 5, 33-40; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

²⁰ Përgjigjja, para. 4, 41-47; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

²¹ Përgjigjja, para. 48, 49; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

²² Përgjigjja, para. 6, 7; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimi ndaj R.3.

²³ Kundërpërgjigjja, para. 1, 2, 4.

²⁴ Kundërpërgjigjja, para. 3.

materiale të propozuara dhe t'ua tregonte dëshmitarëve, duke pasur parasysh se Mbrojtja i ka marrë me kohë dhe ato janë në listën e provave materiale të ZPS-së.²⁵

10. Në Kundërpërgjigje, ZPS-ja gjithashtu kërkon leje për të zëvendësuar përkthimin e dorëzuar të provës materiale të propozuar 155 me versionin e rishikuar të saj dhe tërheq kërkesën në lidhje me provat materiale të propozuara 130, 146, 156, 167, 169, 206 dhe 231, të cilat janë pranuar pas dorëzimit të Mocionit.²⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Dispozitat ligjore që zbatohen në lidhje me aspektet aktuale janë përcaktuar, në veçanti, në nenin 40(6)(h) dhe rregullën 138(1), dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëhershme të Trupit Gjykses.²⁷ Trupi Gjykses do të zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

12. Trupi Gjykses fillimisht rikujton se në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara nuk ekziston një kriter sipas të cilit, para se provat materiale të propozuara të pranohen, dëshmitarët duhet të konfirmojnë autenticitetin e tyre.²⁸ Po kështu, nuk ka asnjë pengesë për pranimin si prova jogojore të provave materiale të propozuara, për arsye të rëndësisë kyçe të pretenduar të tyre për

²⁵ Kundërpërgjigja, para. 5.

²⁶ Kundërpërgjigja, para. 6.

²⁷ *Shih p.sh.*, Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 8-13.

²⁸ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore të Zonës së Llapit, para. 23; Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 12. *Shih gjithashtu* rregullën 138(1). *Shih* Përgjigjen, para. 3-5, 17, 24-40; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.1, C.1.3, C3, C.3.2 dhe C.13.

argumentet e Prokurorisë.²⁹ Të njëjtat kushte dhe kritere pranimi, të përcaktuara në rregullën 138(1), zbatohen për të gjitha kategoritë e provave materiale të propozuara, pavarësisht rëndësisë (së perceptuar) të tyre për argumentet e një pale.³⁰ Ajo që duhet të verifikohet është nëse pala që i paraqet për pranim ka demonstruar relevancën, autenticitetin *prima facie* dhe vlerën provuese të materialeve të paraqitura në bazë të rregullës 138(1) dhe nëse ka treguar se çfarëdo qoftë efekti dëmtues që buron nga pranimi i tyre nuk zhbën vlerën provuese të materialit.

13. Megjithatë, Trupi Gjykues rikujton se mocionet për pranimin e provave jogojore nuk duhet të përdoren si mënyrë për ta bërë jorelevant për këtë proces parimin e dhënies së dëshmisë gojore. Ndonëse procedura për pranimin e provave jogojore është në interes të efikasitetit gjyqësor, ajo nuk duhet të bëhet alternativë e paraqitjes së provave materiale më të rëndësishme nëpërmjet dëshmitarëve që mund të flasin për to dhe të merren në pyetje nga pala jothirrëse në lidhje me to. Edhe kur një provë materiale e propozuar pranohet si provë jogojore, pala që e paraqet atë duhet të marrë në konsideratë përdorimin e saj në gjykatë me dëshmitarin ose dëshmitarët përkatës, kur kjo i shërben kuptimit më të mirë të dokumentit dhe të vendit që ai zë në provat dhe argumentet e palës.³¹ Po kështu, përdorimi i provave materiale të propozuara gjatë dhënies së dëshmive prej dëshmitarëve, mund të japë kontekst relevant të vlefshëm, për shembull, për peshën dhe mbështetshmërinë në atë provë materiale.³² Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues thekson se gjatë gjykimit me dëshmitarët janë përdorur shumë prej dokumenteve që kanë të bëjnë me Zonën Operative të Pashtrikut.

²⁹ Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 84. *Shih* Përgjigjen, para. 6, 7; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimi ndaj R.3.

³⁰ Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 92.

³¹ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 16.

³² Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 17.

14. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se provat materiale të propozuara ishin plot me dokumente me shkrim dore dhe shpesh të panënshkruara, me autorë të paidentifikuar, dhe se ZPS-ja nuk ka dhënë asnjë informacion relevant në lidhje me rrethanat në të cilat u hartuan këto dokumente,³³ Trupi Gjykses rikujton se dokumentet të cilave nuk u përmendet burimi ose ato që nuk kanë tregues të tjerë të prejardhjes së tyre, mund të konsiderohen se u mungojnë treguesit e nevojshëm të autenticitetit.³⁴ Sidoqoftë, fakti që në një dokument nuk përmendet burimi ose që ai është me shkrim dore, nuk nënkupton se dokumenti nuk mund të ketë tregues të tjerë që përcaktojnë se kush ka qenë autori i materialit apo nga e ka burimin.³⁵ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se, kur vlerësohet autenticiteti dhe mbështetshmëria *prima facie* sipas rregullës 138(1), nuk është e nevojshme të vërtetohet prejardhja ose autorësia e materialeve të paraqitura, pasi vërtetimi i këtyre elementëve ka të bëjë me peshën provuese të materialeve të paraqitura e jo me pranueshmërinë e tyre, dhe, për rrjedhojë, këto do të vlerësohen nga Trupi Gjykses në fund të gjykimit, duke marrë parasysh tërësinë e provave të pranuar, në përputhje me rregullën 139(2).³⁶

15. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se fakti që materialet e paraqitura ofrohen si pjesë e përmbledhjeve voluminoze me dokumente, dhe që nganjëherë materialet nuk kanë lidhje të dallueshme me njëri-tjetrin, nuk është pengesë për pranimin e tyre, me kusht që të konstatohet se secili prej materialeve të paraqitura për pranim është relevant, *prima facie* autentik, me vlerë provuese dhe nuk i shkakton dëm të papërligjur Mbrojtjes.³⁷

³³ Përgjigjja, para. 17; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.12 dhe A.1.4.

³⁴ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin si Prova Jogojore të Dokumenteve të Zonës së Llapit, para. 23; Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 59.

³⁵ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin si Prova Jogojore të Dokumenteve të Zonës së Llapit, para. 23.

³⁶ *Shih* Vendimin e Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 82. *Shih* Përgjigjen, para. 17, 51.

³⁷ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin si Prova Jogojore të Dokumenteve të Zonës së Karadakut, para. 10; Vendimi mbi Mocionin për Pranimin si Prova Jogojore të Dokumenteve të Zonës së Llapit, para. 24. *Shih* Përgjigjen, para. 2; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.1, C.1.3, C.4, C.8, C.11, C.12 dhe C.13.

16. Trupi Gjykses tani do të trajtojë argumentin e Mbrojtjes se ZPS-ja kërkon pranimin si prova të dokumenteve që nuk u janë treguar asnjëherë dëshmitarëve përkatës gjatë dhënies së dëshmimeve të tyre para Trupit Gjykses.³⁸ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton se e drejta për ballafaqim nuk do të thotë se pala jothirrëse ka të drejtë të kërkojë që çdo provë materiale apo dokument të paraqitet për pranim përmes një dëshmitari, të cilin më pas pala jothirrëse do të jetë në gjendje ta marrë në pyetje lidhur me përmbajtjen e dokumentit. Megjithatë, në qoftë se pala thirrëse nuk ua paraqet provat materiale të propozuara dëshmitarëve që mund të japin kontekst për to, kjo mund të ndikojë negativisht në peshën që Trupi Gjykses mund të jetë i gatshëm t'u japë atyre provave materiale në fund të gjykimit.³⁹

17. Në lidhje me këtë Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja kundërshton në veçanti pranimin e dokumenteve që lidhen me W04745-ën⁴⁰ për arsye se ato nuk iu treguan asnjëherë dëshmitarit që ai të konfirmonte autenticitetin e tyre.⁴¹ Trupi Gjykses vëren se disa prova materiale të propozuara të paraqitura në Mocion, ishin përfshirë prej ZPS-së në njoftimin për dokumentet që do të përdorte me W04745-ës gjatë dëshmisë gojore të tij.⁴² Ky ishte tregues i synimit fillestar të ZPS-së për t'i përdorur këto dokumente me dëshmitarin; megjithatë, jo për faj të saj, ajo nuk mundi ta bënte këtë për shkak të mungesës së bashkëpunimit të W04745-ës.⁴³ Mosbashkëpunimi i një dëshmitari me një palë nuk mund të shërbejë si bazë për mospranimin e dokumenteve për të cilat dëshmitari mund të kishte dhënë

³⁸ Përgjigjja, para. 5, 33-40; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

³⁹ Vendimi në lidhje me Dokumentet e Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut, para. 14; *Shih* rregullën 139(2).

⁴⁰ Përgjigjja, para. 35, 36.

⁴¹ Transkripti i seancës, 24 shkurt 2025, konfidencial; Transkripti i seancës, 25 shkurt 2025, konfidencial.

⁴² *Krahaso p.sh.*, Shtojcën 1 të Mocionit, provat materiale të propozuara 7, 8, 9, 153, 156, 239, 251, 252, 256, 257, 258, 259, 260, 263, 264 dhe Shtojcën 1 të parashtrimit F02833, Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarët e Periudhës pas Janarit 2025, 14 janar 2025, konfidenciale, përkatësisht materialet 9, 10, 25, 21, 20, 19, 18, 17, 13, 15, 16, 11, 12, 14, 22.

⁴³ Transkripti i seancës, 1 prill 2025, f. 26121, rreshti 14 deri në f. 26126, rreshti 20.

kontekst ose mbi të cilat mund të kishte bërë komente. Rrjedhimisht, argumenti i Mbrojtjes është i pathemeltë.

18. Në mënyrë të ngjashme, Trupi Gjykses gjykon se fakti që autenticiteti i disa prej dokumenteve nuk u vërtetua, dhe ato nuk u konfirmuan dhe madje në disa raste u kundërshtuan prej dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi, apo prej provave të tjera në dokumentacionin e çështjes,⁴⁴ nuk e pengon pranimin e tyre, në qoftë se përmbushen kriteret e rregullës 138, por kjo mund të ndikojë negativisht në peshën që Trupi Gjykses mund të jetë i gatshëm t'u japë atyre provave materiale.

19. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja kundërshton veçanërisht pranimin e provave materiale të propozuara që lidhen me W04460-en, me arsyetimin se W04460 nuk konfirmoi autenticitetin e disa prej provave materiale të propozuara, dhe ZPS-ja më pas e hoqi këtë dëshmitar nga lista e dëshmitarëve të saj. Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se për të mbështetur autenticitetin e këtyre provave materiale të propozuara, ZPS-ja bazohet në mënyrë të palejueshme në pretendimin e saj se ato u sekuestruan nga shtëpia e W04460-ës.⁴⁵ Trupi Gjykses është i mendimit se pjesa e parë e argumenteve të Mbrojtjes ka të bëjë me peshën provuese që do t'u japë Trupi Gjykses këtyre provave, të cilën do ta vlerësojë vetëm në fund të gjykimit, në kuadër të tërësisë së provave. Trupi Gjykses gjithashtu rithekson se konfirmimi i autenticitetit të një dokumenti në kuadër të procesit të pranimi, nuk ka nevojë të bëhet nëpërmjet dëshmitarit. Lidhur me pjesën e dytë të argumentit të Mbrojtjes, Mbrojtja nuk shpjegon si dhe pse është e palejueshme që ZPS-ja të përmendë faktin që dokumenti u sekuestrua në shtëpinë e W04460-ës si një nga treguesit e autenticitetit të tij. Edhe ky argument duhet të rrëzohet.

20. Mbrojtja më tej pretendon se, për të konfirmuar autenticitetin e dokumenteve të paraqitura në këtë mocion për pranim si prova jогоjore, ZPS-ja u referohet

⁴⁴ Përgjigja, para. 4, 41, 47-49; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

⁴⁵ Përgjigja, para. 32; Shtojca 1 e Përgjigjes, provat materiale të propozuara 274, 278.

materialeve që nuk janë pjesë e provave e që nuk janë paraqitur për t'u pranuar si prova.⁴⁶ Trupi Gjykses ka theksuar vazhdimisht se nuk do të bazohet në materiale që nuk janë pranuar ose që nuk janë paraqitur për t'u pranuar si prova për të vendosur mbi pranimin e materialeve të tjera.⁴⁷ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se që një material të pranohet si provë jogojore, ai duhet të përmbushë kriteret kumulative të rregullës 138(1).⁴⁸ Konfirmimi bazuar në material që as është pranuar e as është ofruar për t'u pranuar si provë, mund të ndihmojë për të vendosur nëse janë përmbushur këto kritere kur kjo nuk është e dukshme nga vetë dokumenti; por, sidoqoftë, siç u theksua më lart, konfirmimi, në vetvete, nuk është kriter për pranimin.⁴⁹

21. Trupi Gjykses tani do të vlerësojë nëse provat materiale të propozuara janë të pranueshme në bazë të rregullës 138. Për këtë, Trupi Gjykses do t'u referohet provave materiale të propozuara sipas numërimit të tyre në Shtojcën 1 të Mocionit.

B. VLERËSIMI I PROVAVE MATERIALE TË PROPOZUARA

1. Provat materiale të propozuara 1-23: Dokumentet në lidhje me komandën e Zonës Operative të Pashtrikut

(a) Relevanca

22. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 1-23, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) kontrollin, menaxhimin dhe administrimin prej komandës së Zonës Operative të Pashtrikut të njësiteve dhe anëtarëve të UÇK-së në vitet 1998 dhe 1999; (ii) shkallën e anëtarësimit, organizimit dhe funksionimit të njësiteve speciale të UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut; dhe (iii) komandën dhe kontrollin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së mbi strukturën

⁴⁶ Përgjigja, para. 21; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj C.3, C.3.4, C.8.

⁴⁷ Vendimi në lidhje me Dokumentet e Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut, para. 15; Vendimi mbi Mocionin për Pranimin si Prova Jogojore të Dokumenteve të Zonës së Drenicës, para. 10.

⁴⁸ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 9.

⁴⁹ Vendimi në lidhje me Dokumentet e Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut, para. 15.

komanduese të Zonës Operative të Pashtrikut.⁵⁰ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues thekson se: (i) provat materiale të propozuara 3, 11 dhe 14 janë dokumente të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ku përfshihen vendime për emërimin e shtabit të komandës së Zonës Operative të Pashtrikut (“vendimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së”); (ii) provat materiale të propozuara 1, 4, 9, 12 dhe 15 janë dokumente në lidhje me emërimin, lëvizjen ose transferimin e personelit ushtarak, dokumente në lidhje me personelin dhe masat disiplinore ndaj anëtarëve të UÇK-së (“dokumentet për personelin”); (iii) provat materiale të propozuara 2 dhe 16 janë dokumente që lidhen me logjistikën (“dokumentet logjistike”); (iv) provat materiale të propozuara 5-8 dhe 10 janë dokumente që lidhen me aspekte financiare (“dokumentet financiare”); (v) prova materiale e propozuar 13 është një fletore me shënime me shkrim dore, që përmban informacion në lidhje me funksionimin dhe aktivitetet e UÇK-së; dhe (vi) provat materiale të propozuara 17-23 janë formularë standardë të UÇK-së (“formularët”).⁵¹

23. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në një numër provash materiale të propozuara që lidhen me komandën e Zonës Operative të Pashtrikut për të demonstruar, ndër të tjera, se: (i) Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte dhe ushtronte pushtetin e tij në Zonën Operative të Pashtrikut, edhe me anë të mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë ose zbatimit të rregullave dhe rregulloreve;⁵² (ii) Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së emëroi, me një urdhër me shkrim, Musë Jasharin si komandant të Zonës Operative të Pashtrikut, dhe më vonë, emëroi Ekrem Rexhën (të njohur dhe si komandant Drini) në të njëjtën pozitë;⁵³ (iii) përbërja e shtabit të komandës së Zonës Operative të Pashtrikut përputhej me

⁵⁰ Shtojca 1 e Mocionit, f. 2-18, provat materiale të propozuara 1-23.

⁵¹ Në lidhje me provën materiale të propozuar 14, Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja paraqet për pranim vetëm këto pjesë: U003-1741-U003-1749, f. U003-1743, U003-1747-U003-1749, pasi pjesa U003-1741-U003-1749, f. U003-1744-U003-1746 u pranua pjesërisht si prova P00650.

⁵² Mocioni, para. 5, 6.

⁵³ Mocioni, para. 12.

atë të zonave të tjera operative dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, përfshirë sektorë të ndryshëm si administrata, logjistika ose financa;⁵⁴ dhe (iv) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut mbante takime të rregullta, ishte përgjegjëse për njësitet e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut, lëshonte dhe merrte urdhra, udhëzime dhe rregullore, të cilat më pas i zbatonte.⁵⁵

24. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 1-18 dhe 21-23, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.⁵⁶

25. Në lidhje me provat materiale të propozuara 19 dhe 20, Trupi Gjykses vëren se ato janë formularë standardë të paplotësuar, me emblemën/emrin e UÇK-së në krye. Trupi Gjykses vëren se këto dokumente nuk kanë asnjë përmbajtje tjetër. ZPS-ja parashtrohet se këto dokumente provojnë nivelin e organizimit të Zonës Operative të Pashtrikut. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja ka paraqitur dhe dokumente të tjera të tilla për këtë qëllim.⁵⁷ Relevanca dhe vlera provuese e secilit dokument më vete është mjaft e kufizuar. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se shtrirja dhe përhapja e këtyre dokumenteve në radhët e UÇK-së dhe zonave operative të ndryshme mund të jetë relevante për të demonstruar nivelin e organizimit të UÇK-së, si dhe faktin se ajo përdorte disa procedura të njëjta në gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha vendet. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se këta formularë standardë janë relevantë dhe kanë vlerë provuese *prima facie* në këtë proces.

⁵⁴ Mocioni, para. 13.

⁵⁵ Mocioni, para. 14.

⁵⁶ Shih p.sh. F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar* ("Aktakuza"), 30 shtator 2022, konfidenciale, para. 8-55; shih gjithashtu F01594/A03, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake* ("Dosja Paraprake e ZPS-së"), 9 qershor 2023, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 prill 2023, F01415/A01), para. 178, 228-239. Shih Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

⁵⁷ Shih p.sh., provat materiale të propozuara 17, 18.

(b) Autenticiteti

26. Lidhur me autenticitetin, Trupi Gjykses thekson se shumica e provave të propozuara 1-23 janë dokumente të asaj kohe, të daktilografuara ose me shkrim dore dhe me nënshkrime që duket se janë të anëtarëve të UÇK-së.

27. Lidhur me vendimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Trupi Gjykses vëren se të gjitha provat materiale të propozuara kanë emrin e UÇK-së në krye, janë të vulosura, të nënshkruara, kanë data dhe numra reference.⁵⁸ Në lidhje me provën materiale të propozuar 3, Trupi Gjykses vëren se në të përmendet emri i komandantit të Zonës Operative të Pashtrikut, që përmendet edhe në fakte të shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.⁵⁹ Gjithashtu, provat materiale të propozuara 11 dhe 14 janë të nënshkruara nga Ekrem Rexha (i njohur dhe si komandant Drini). Po kështu, Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 11 u sekuestrua në shtëpinë e z. Selimi.⁶⁰

28. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja kundërshton pranimin e provës materiale të propozuar 14, me arsyetimin se W04691 ngriti shqetësime për autenticitetin dhe mbështetshmërinë në këtë provë.⁶¹ Sidoqoftë, Trupi Gjykses thekson se informacioni në të cilin kërkon të mbështetet Mbrojtja nuk është pranuar në dokumentacionin e kësaj çështjeje gjyqësore dhe, rrjedhimisht, nuk ofron bazë mbi të cilën të merret vendim për pranueshmërinë e tij.

⁵⁸ Provat materiale të propozuara 3, 11, 14.

⁵⁹ *Shih* Faktin e shqyrtuar 242(e).

⁶⁰ *Shih* F00030, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Autorizimin e Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 26 tetor 2020, konfidencial; F00100, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin në zbatim të Vendimit KSC-BC-2020-06-F00030*, 23 nëntor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00214, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë mbi Rishikimin e Sendeve të Sekuestruara në përputhje me Vendimet KSC-BC-2020-06/F00028, KSC-BC-2020-06/F00029, KSC-BC-2020-06/F00030 dhe KSC-BC-2020-06/F00031COR*, 11 mars 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00366, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listave të Materialeve të Sekuestruara*, 23 qershor 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶¹ Përgjigja, para. 28; Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 22-25, prova materiale e propozuar 14.

29. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se vendimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

30. Në lidhje me dokumentet për personelin, Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 1 është e nënshkruar, ka datë dhe përmbajtja e dokumentit konfirmohet nga prova të tjera të pranuara në dokumentacionin e çështjes gjyqësore.⁶² Ndërsa prova materiale e propozuar 4 nuk është e vulosur, mban si datë vitin “1998” dhe ka vendin për vënien e nënshkrimit nga komandant Agim Demiri, roli i të cilit në batalionin e UÇK-së konfirmohet dhe nga prova të tjera të pranuara në dokumentacionin e çështjes gjyqësore.⁶³ Gjithashtu, prova materiale e propozuar 9 ka emrin e UÇK-së në krye, numër reference dhe është e nënshkruar nga Ekrem Rexha (i njohur dhe si komandant Drini). Po kështu, provat materiale të propozuara 12 dhe 15 janë të nënshkruara, të vulosura dhe kanë data. Trupi Gjykses gjykon se kundërshtimi i Mbrojtjes se prova materiale e propozuar 15 përmban shkurtesa të panjohura të cilave duhet t’u përcaktohet konteksti, nuk ka ndonjë rëndësi në këtë fazë.⁶⁴ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për personelin kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

31. Në lidhje me dokumentet logjistike, Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara 2 dhe 16 kanë emrin e UÇK-së dhe/ose emblemën e UÇK-së në krye, janë të vulosura, kanë si datë gushtin e vitit 1999 dhe janë të nënshkruara nga komandanti i Zonës Operative të Pashtrikut Tahir Sinani, roli i të cilit konfirmohet dhe nga prova të tjera të pranuara në dokumentacionin e çështjes gjyqësore. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet logjistike kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

⁶² Prova materiale e propozuar 1.

⁶³ Prova materiale e propozuar 4.

⁶⁴ *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 25, 26, provën materiale të propozuar 15.

32. Lidhur me dokumentet financiare,⁶⁵ Trupi Gjykses thekson se ato datojnë të gjitha në vitin 1999, kanë fjalët Zona Operative e Pashtrikut e UÇK-së në krye, janë të shkruara në formularë standardë që kanë ngjashmëri me njëri-tjetrin, kanë numra reference dhe janë të nënshkruara ose nga komandanti i Zonës Operative të Pashtrikut Ekrem Rexha (i njohur dhe si komandant Drini) ose nga Ismet Tara, i cili dëshmoi gjatë dëshmisë së tij se ka qenë shef i financës dhe logjistikës për Zonën Operative të Pashtrikut.⁶⁶ Gjithashtu, në të gjitha këto dokumente përmenden shuma të hollash që duhej të ndaheshin dhe t'u shpërndaheshin brigadave përkatëse të Zonës Operative të Pashtrikut. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se provat materiale të propozuara 5, 8 dhe 10 u sekuestruan në shtëpinë e z. Selimi.⁶⁷ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet financiare kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

33. Në lidhje me provën materiale të propozuar 13, Trupi Gjykses vëren se ajo është një fletore me shënime me shkrim dore dhe pa nënshkrim ku është një listë ushtarësh që pretendohet se i përkisnin njësitit Çeliku 5. Trupi Gjykses mban parasysh kundërshtimin e Mbrojtjes se prova materiale e propozuar 13 nuk përmban informacion për prejardhjen e saj ose shenja të autorësisë dhe duket se është shkruar nga më shumë se një autor.⁶⁸ Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se shënimet në fletore lidhen me periudhën shkurt-mars 1999, d.m.th, me një periudhë relevante për Aktakuzën, dhe se provat e tjera në dokumentacionin e çështjes, ose ato të paraqitura në Mocion, konfirmojnë përmbajtjen dhe thelbin e provës materiale të propozuar 13, konkretisht ekzistencën dhe funksionimin e njësitit Çeliku 5.⁶⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e

⁶⁵ Provat materiale të propozuara 5, 6, 7, 8, 10.

⁶⁶ Seanca gjyqësore, 25 shkurt 2025, f. 25600, rreshtat 2-4.

⁶⁷ *Shih* më lart, poshtëshënimin 60.

⁶⁸ Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 20, 21, prova materiale e propozuar 13.

⁶⁹ Shtojca 1 e Mocionit, prova materiale e propozuar 13.

propozuar 13 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

34. Në lidhje me formularët standardë,⁷⁰ Trupi Gjykses vëren se të gjithë kanë fjalët UÇK, Zona Operative e Pashtrikut në krye dhe/ose emblemën e saj dhe formate të ngjashme me njëri-tjetrit. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 18, 21, 22 dhe 23 kanë edhe vendin ku vihet nënshkrimi dhe emri i komandantit të UÇK-së, dhe provat materiale të propozuara 21, 22 dhe 23 kanë numrin e publikimit. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se formularët standardë përmbajnë udhëzime operative për kompani këmbësorie të veçanta. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se formularët standardë kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentikë.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

35. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 1-23 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me fakte dhe rrethana relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 1-23 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

36. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 1-23 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

⁷⁰ Provat materiale të propozuara 17-23.

2. Provat materiale të propozuara 24-32: Llapushniku

(a) Relevanca

37. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 24⁷¹-32, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) strukturën dhe organizimin e UÇK-së në zonën e Llapushnikut, dhe aktivitetin e njësiteve dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre; (ii) ekzistencën e konfliktit të armatosur; dhe (iii) krimet për të cilat janë ngritur akuzat në Aktakuzë si dhe ekzistencën e qëllimit kriminal të përbashkët.⁷² Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 24 dhe 32 janë ditarë të shkruar me dorë në lidhje me aktivitetet e UÇK-së në Llapushnik; (ii) provat materiale të propozuara 25-29 janë dokumente që kanë të bëjnë me kontrollime dhe sekuestime, masa disiplinore dhe lista të ushtarëve të UÇK-së (“dokumentet për personelin”); dhe (iii) provat materiale të propozuara 30 dhe 31⁷³ janë dokumente në lidhje me arrestimin dhe sekuestrimin e gjësendeve nga ata që dyshohej se ishin bashkëpunëtorë dhe armiq (“dokumentet për bashkëpunëtorët”).

38. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 24-32 për të demonstruar, ndër të tjera, se: (i) njësitet dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet në zonat nën kontrollin e tyre, përfshirë zonën e Llapushnikut dhe rreth tij;⁷⁴ (ii) në maj 1998, UÇK-ja kontrollonte grykën e Llapushnikut;⁷⁵ (iii) komandantët e njësiteve të UÇK-së mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët, armatimin dhe detyrat e tyre;⁷⁶ dhe (iv) anëtarët e Zonës Operative të Pashtrikut hetonin, shënjestronin,

⁷¹ Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 24 është shënuar për identifikim si P01804 MFI.

⁷² Shtojca 1 e Mocionit, f. 19-24, provat materiale të propozuara 24-32.

⁷³ Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 31 është shënuar për identifikim si P01803 MFI.

⁷⁴ Motion, para. 4.

⁷⁵ Mocioni, para. 9.

⁷⁶ Mocioni, para. 16.

arrestonin dhe ndalonin bashkëpunëtorët e pretenduar dhe kundërshtarët të tjerë.⁷⁷

39. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 24-30 dhe 32, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë janë relevante për pretendimet dhe akuzat e përfshira në Aktakuzë.⁷⁸

40. Lidhur me provën materiale të propozuar 31, Trupi Gjykses mban parasysh argumentin e ZPS-së se ky material supozohet se demonstroi autoritetin e UÇK-së për të arrestuar njerëz dhe sekuestruar gjësendet personale të të ndaluarve.⁷⁹ Ndonëse W04798 pranoi se e kishte marrë këtë dokument ndërtesën e MPB-së në Llapushnik në korrik 1998, për këtë material nuk jepet asnjë kontekst tjetër. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se në përmbajtjen e provës materiale të propozuar 31 nuk ka asgjë që tregon se ajo është relevante për Aktakuzën dhe akuzat në të. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk është bindur se prova materiale e propozuar 31 nuk është relevante.

(b) Autenticiteti

41. Sa i përket dokumenteve për personelin,⁸⁰ Trupi Gjykses thekson se shumica dërrmuese e këtyre materialeve kanë data, përmbajnë referenca për njësinë përkatëse dhe janë të nënshkruara. Trupi Gjykses vëren se ndonëse prova materiale e propozuar 29 nuk është e nënshkruar, ajo është një listë ushtarësh që ka ngjashmëri me provën materiale të propozuar 28, dhe në të përmendet njësi Guri 3, një njësi i njohur e UÇK-së. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se informacioni që përmban prova materiale e propozuar 29 konfirmohet pjesërisht nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes gjyqësore.⁸¹ Gjithashtu, Trupi

⁷⁷ Mocioni, para. 19.

⁷⁸ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 303-309. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

⁷⁹ Shtojca 1 e Mocionit, f. 23, 24, prova materiale e propozuar 31.

⁸⁰ Provat materiale të propozuara 25-29.

⁸¹ Shtojca 1 e Mocionit, f. 22, 23, prova materiale e propozuar 29.

Gjykues vëren se prova materiale e propozuar 25 u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi. Për këto arsye, Trupi Gjykues është bindur se dokumentet për personelin kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

42. Në lidhje me provën materiale të propozuar 30, Trupi Gjykues së pari vëren se një pjesë e këtij materiali është e njëjtë me atë që është pranuar më parë si prova P01792.⁸² Trupi Gjykues vëren se ky material ka ngjashmëri me pjesën e po këtij materiali që është pranuar dhe përmbajtja e këtij materiali konfirmohet edhe nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes si dhe nga faktet e shqyrtuara në procese të tjera për të cilat Trupi Gjykues ka bërë konstatim gjyqësor.⁸³ Për këto arsye, Trupi Gjykues është bindur se prova materiale e propozuar 30 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

43. Në lidhje me provën materiale të propozuar 24, Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja kundërshton pranimin e saj dhe argumenton se kjo provë materiale nuk duhet të përfshihet në Mocion në tërësi, por vetëm faqe të veçanta të saj të përdorura me dëshmitarë, të cilat dëshmitari i ka kontekstualizuar u ka konfirmuar autenticitetin.⁸⁴ Trupi Gjykues vëren se në provën materiale të propozuar 24 përshkruhen hollësisht dhe pothuaj në mënyrë të përditshme aktivitetet e një njësie të UÇK-së. Aty gjithashtu përmendet një numër komandantësh të UÇK-së. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se përmbajtja e provës materiale të propozuar 24 konfirmohet edhe nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes.⁸⁵ Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se edhe prova materiale e propozuar 24 është *prima facie* autentike. Duke pasur parasysh se informacioni që përmban prova materiale mbulon një periudhë kohe relevante

⁸² Shih Transkriptin e seancës, 30 tetor 2024, konfidencial, f. 21507, rreshtat 5, 6.

⁸³ Shih Faktet e shqyrtuara 396, 422 dhe 423. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Mocionit, që i referohet, në pjesët përkatëse, provave P00869 dhe P01802.

⁸⁴ Përgjigjja, para. 50, 51; Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 39, prova materiale e propozuar 24.

⁸⁵ Shtojca 1 e Mocionit, f. 24, 25, prova materiale e propozuar 24.

për Aktakuzën, Trupi Gjykses nuk pajtohet me Mbrojtjen se duhet të pranohen vetëm disa pjesë të provës materiale të propozuar 24.

44. Lidhur me provën materiale të propozuar 32, Trupi Gjykses vëren se ajo përmban shënime me shkrim dore ndërmjet shkurtit 1999 dhe prillit 1999.⁸⁶ Ndonëse nuk është nënshkruar, në të është shkruar emri i një ushtari të UÇK-së, pozita e të cilit konfirmohet nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes.⁸⁷ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 32 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

45. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 24-30 dhe 32 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 24-30 dhe 32 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

(d) Përfundim

46. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 24-30 dhe 32 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1) dhe refuzon, në formë jo të prerë, pranimin e provës materiale të propozuar 31.

47. Pasi ka konstatuar se prova materiale e propozuar 24 është e pranueshme, Trupi Gjykses gjithashtu udhëzon Zyrën Administrative që të pasqyrojë statusin e provës P01804 MFI si provë e pranuar.

⁸⁶ Prova materiale e propozuar 32.

⁸⁷ Shtojca 1 e Mocionit, f. 24, prova materiale e propozuar 32.

3. Provat materiale të propozuara 33-50: Malisheva

(a) Relevanca

48. Lidhur me relevancën e provave materiale të propozuara 33-50, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) hierarkinë, strukturën dhe organizimin e njësive të UÇK-së, ndër to njësitet Lumi dhe Çeliku në Zonën Operative të Pashtrikut dhe në zonën e Malishevës; dhe (ii) aftësinë e njësive të ndryshme të UÇK-së për të lëshuar dhe zbatuar urdhra.⁸⁸ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vëren se: (i) provat materiale të propozuara 33 dhe 49 janë plane lufte dhe një hartë e Malishevës (“dokumentet për luftimet”); (ii) provat materiale të propozuara 34-39, 44-47 dhe 50 janë dokumente si shënime për anëtarësimet, lista të ushtarëve, leje udhëtimi, shpërndarje armësh dhe rregulla për miratimin dhe autorizimin e lëvizjes së personelit (“dokumentet për personelin”); (iii) provat materiale të propozuara 40-43 janë raporte për masat disiplinore ndaj anëtarëve të njësive (“dokumentet për masat disiplinore”); dhe (iv) prova materiale e propozuar 48 është një raport vlerësimi nga udhëheqësia e LDK-së.

49. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 33-50 për të demonstruar, ndër të tjera, se: (i) njësitet dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet në ato zona, përfshirë Malishevën;⁸⁹ (ii) të paktën nga marsi 1998, Gani Krasniqi dhe Hysni Kilaj filluan të rekrutojnë anëtarë për njësitin Lumi dhe themeluan baza të UÇK-së në qytetin e Malishevës dhe zonat përreth;⁹⁰ (iii) nga maji 1998, Malisheva ishte nën kontrollin e UÇK-së;⁹¹ dhe (iv) komandantët e njësive përkatëse administronin dhe shpërndanin armë dhe furnizime, mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët e njësive, armatimin dhe detyrat e tyre, dhe

⁸⁸ Shtojca 1 e Mocionit, f. 25-37, provat materiale të propozuara 33-50.

⁸⁹ Mocioni, para. 4.

⁹⁰ Mocioni, para. 8.

⁹¹ Mocioni, para. 9.

paralajmëronin se për mosbindje ose moszbatim të urdhrave do të merreshin masa disiplinore.⁹²

50. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 33-50, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.⁹³

(b) Autenticiteti

51. Lidhur me dokumentet për luftimet,⁹⁴ Trupi Gjykses vëren se ato janë dokumente të daktilografuara, dhe përmbajnë shënime me shkrim dore. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se, ndonëse dokumentet për luftimet nuk janë të nënshkruara, nuk kanë data e nuk janë të vulosura, ato përmbajnë informacion të hollësishëm në lidhje me operacionet luftarake në zonën e Malishevës, si dhe lista të ushtarëve me të dhënat personale të tyre edhe një listë të komandantëve të togave ose skuadrave përkatëse. Për më tepër, prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes, ndër të cilat edhe dëshmi të dëshmitarëve, ofrojnë njëfarë konfirmimi të përmbajtjes së përgjithshme të dokumenteve për luftimet.⁹⁵ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për luftimet kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

52. Lidhur me dokumentet për personelin,⁹⁶ Trupi Gjykses vëren se ato janë shënime me shkrim dore ku tregohen me hollësi lëvizjet e personelit dhe armatimit. Veç kësaj, provat materiale të propozuara 34, 38, 39, 45 dhe 47 kanë data dhe/ose janë të nënshkruara. Gjithashtu, në dokumentet për personelin përmenden njësitet Guri 3 dhe Lumi, ose ata që supozohej se ishin komandantë të Zonës Operative të Pashtrikut. Anëtarësia e disa prej ushtarëve në lista

⁹² Mocioni, para. 16.

⁹³ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 229, 359-367. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

⁹⁴ Provat materiale të propozuara 33 dhe 49.

⁹⁵ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, në pjesët përkatëse.

⁹⁶ Provat materiale të propozuara 34-39, 44-47 dhe 50. Në lidhje me provën materiale të propozuar 36, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk kërkon të paraqesë për pranim faqet U002-2186-U002-2192.

konfirmohet pjesërisht nga prova të tjera të pranuara në dokumentacionin e çështjes, ose të paraqitura në Mocion.⁹⁷ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për luftimet kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

53. Në lidhje me dokumentet për masat disiplinore,⁹⁸ Trupi Gjykses vëren se ato janë shënime me shkrim dore ku përshkruhen ngjarje që thuhet se kanë ndodhur në korrik 1998. Të gjitha këto materiale kanë data, u referohen vendeve ku kanë shërbyer ushtarët e përmendur, si dhe njësitet Lumi dhe Guri. Ndonëse Trupi Gjykses vëren se dokumentet për masat disiplinore kanë pjesë të palexueshme, kjo nuk ndikon në autenticitetin e përgjithshëm të tyre, pasi natyra dhe thelbi i materialit mund të kuptohet nga pjesa tjetër e përmbajtjes. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për masat disiplinore kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

54. Në lidhje me provën materiale të propozuar 48, Trupi Gjykses vëren se ky material ka datë, është i nënshkruar dhe në të përmenden ngjarje që kanë ndodhur në Malishevë. Gjithashtu, anëtarësia e personit të përmendur në dokument konfirmohet nga provat e pranuara në dokumentacionin e çështjes.⁹⁹ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 48 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike .

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

55. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 33-50 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave

⁹⁷ Shih Shtojcën 1 të Mocionit, në pjesët përkatëse.

⁹⁸ Provat materiale të propozuara 40-43.

⁹⁹ Shih P01198.1_ET; Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Mocionit, f. 35, provën materiale të propozuar 48.

materiale të propozuara 33-50 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

56. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 33-50 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

4. Provat materiale të propozuara 51-98: shtabi i Vrrinit dhe Jeshkovës

(a) Relevanca

57. Lidhur me relevancën e provave materiale të propozuara 51-98, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) organizimin dhe strukturën ushtarake të UÇK-së në zonën e Vrrinit, zonën e Prizrenit dhe Zonën Operative të Pashtrikut në verën e vitit 1998; (ii) aftësinë e njësive përkatëse të UÇK-së për të mbajtur evidenca dhe regjistra; (iii) ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar gjatë periudhës që mbulon Aktakuza; dhe (iv) ekzistencën e politikës së UÇK-së ndaj atyre që perceptoheshin si bashkëpunëtorë dhe qëllimin kriminal të përbashkët.¹⁰⁰ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 51-53, 55, 69, 85, 91 dhe 92 janë lista, evidenca, orare kujdestarie të ushtarëve dhe leje udhëtimi (“dokumentet për personelin”); (ii) provat materiale të propozuara 54, 63, 65, 66, 72, 75, 80, 83, 84, 86 dhe 87 janë shënime dhe evidenca për furnizimin dhe shpërndarjen e municionit dhe armëve, si dhe shënime dhe evidenca për furnizime të tjera (“dokumentet logjistike”); (iii) provat materiale të propozuara 56, 74, 77, 78, 90 dhe 93 janë urdhra të lëshuara personelit vendor nga komandantët e UÇK-së, procesverbale të takimeve të shtabit të UÇK-së, vula e shtabit të UÇK-së në Prizren dhe një diagram i kodeve të komunikimit të përdorura prej komandantit të Zonës Operative të Pashtrikut me shtabin vendor të Prizrenit (“dokumentet e komandës së UÇK-së”); (iv) provat materiale të propozuara 57, 58, 60, 61, 64, 68, 70, 89 dhe 95 janë shënime që tregojnë se si ishte gjendja në kufi,

¹⁰⁰ Shtojca 1 e Mocionit, f. 38-72, provat materiale të propozuara 51-98.

ditarë dhe shënime në lidhje me operacionet luftarake dhe luftimet, shënime të mbajtura në takimet në lidhje me mbrojtjen civile dhe situatën në terren, dhe plane ushtarake të UÇK-së (“dokumentet për luftimet”); (v) provat materiale të propozuara 59,¹⁰¹ 76, 79, 81, 82,¹⁰² dhe 98 janë shënime dhe deklarata në lidhje me bashkëpunëtorë të pretenduar (“dokumentet për bashkëpunëtorët”); (vi) provat materiale të propozuara 62, 94 dhe 97 janë fatura dhe dëftesa (“dokumentet financiare”); dhe (vii) provat materiale të propozuara 67, 71 dhe 88 janë deklarata mbi incidente dhe kërkesa për masa disiplinore (“dokumentet për masat disiplinore”).

58. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 51-98 për të demonstruar, ndër të tjera, se: (i) në qershor 1998, Vrrini u shpall zonë e lirë dhe, në koordinim me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, UÇK-ja krijoi komandën vendore të saj për Prizrenin në Jeshkovë;¹⁰³ (ii) njësitë dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet e tyre në zona, përfshirë Jeshkovën;¹⁰⁴ (iii) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut mbante takime të rregullta, ishte përgjegjëse për njësitë e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut dhe bënte e merrte raporte dhe urdhra, udhëzime dhe rregullore;¹⁰⁵ (iv) komandantët e njësive përkatëse administronin dhe shpërndanin armët dhe furnizimet, mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët e njësive, armatimin dhe detyrat e tyre, dhe paralajmëronin se për mosbindje ose moszbatim të urdhrave do të merreshin masa disiplinore; dhe (v) anëtarët e brigadës së Zonës Operative të Pashtrikut hetonin dhe/ose ndalonin bashkëpunëtorë të pretenduar.¹⁰⁶

¹⁰¹ Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja kërkon të paraqesë për pranim vetëm faqen U000-4854. *Shih* Shtojcën 1, f. 42; provën materiale të propozuar 59.

¹⁰² Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja kërkon të paraqesë për pranim vetëm faqet D008-5363-D008-5364 dhe D008-5412. *Shih* Shtojcën 1, f. 60, provën materiale të propozuar 82.

¹⁰³ Mocioni para. 9.

¹⁰⁴ Mocioni, para. 4.

¹⁰⁵ Mocioni, para. 14.

¹⁰⁶ Mocioni, para. 16.

59. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 51-64 dhe 66-98, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.¹⁰⁷

60. Në lidhje me provën materiale të propozuar 65, Trupi Gjykses vëren se pjesa më e madhe e këtij materiali përbëhet nga një listë të furnizimeve, e cila ka relevancë shumë të kufizuar pa pasur kontekstualizimin e duhur. Krahasuar me materiale të tjera të ngjashme të paraqitura në Mocion, të cilat Trupi Gjykses i konsideron të përshtatshme për t'u pranuar si prova,¹⁰⁸ kjo provë materiale ofron shumë pak kontekst se çka synohet me të. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është bindur se është treguar se prova materiale e propozuar 65 ka vlerë provuese në lidhje me ndonjë fakt relevant për këtë çështje.

(b) Autenticiteti

61. Lidhur me dokumentet për personelin,¹⁰⁹ Trupi Gjykses vëren se të gjitha ato kanë data dhe referenca për komandantët e njësive përkatëse, si edhe referenca për operacionet e UÇK-së, dhe në to përmendet në mënyrë të përsëritur Agim Shala, pozita e pretenduar e të cilit në UÇK konfirmohet nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 69, 85, dhe 91 janë të nënshkruara dhe kanë emblemën e UÇK-së. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për personelin kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

62. Në lidhje me dokumentet logjistike,¹¹⁰ Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara 63, 66, 72, 75, 80, 83, 84, 86 dhe 87 janë të gjitha të nënshkruara, kanë datë dhe në to përmenden operacionet e UÇK-së në Prizren ose Jeshkovë. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 72, 75, 86 dhe 87 kanë emrin

¹⁰⁷ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 403-411. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

¹⁰⁸ *Shih p.sh.* provat materiale të propozuara 80, 83.

¹⁰⁹ Provat materiale të propozuara 51-53, 55, 69, 85, 91, 92.

¹¹⁰ Provat materiale të propozuara 54, 63, 66, 72, 75, 80, 83, 84, 86 dhe 87.

e UÇK-së ose emblemën e saj në krye dhe provat materiale të propozuara 75, 83 dhe 86 janë edhe të vulosura. Në provën materiale të propozuar 54 përmendet Jeshkova dhe pozitat në UÇK të disa prej ushtarëve të përmendur në dokument konfirmohen nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet logjistike kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

63. Në lidhje me dokumentet e komandës së UÇK-së,¹¹¹ Trupi Gjykses vëren se shumica e dokumenteve janë me shkrim dore dhe në to përmenden veprimtari ose çështje të komandës së UÇK-së në Prizren, thelbi i të cilave konfirmohet nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes gjyqësore.¹¹² Gjithashtu, prova materiale e propozuar 90 është e nënshkruar nga komandant “Sokoli” dhe, së bashku me provën materiale të propozuar 93, ka edhe datë. Veç kësaj, në lidhje me provën materiale të propozuar 77, Trupi Gjykses vëren se në të përmenden emra dhe fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.¹¹³ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet e komandës së UÇK-së kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

64. Në lidhje me dokumentet për luftimet,¹¹⁴ Trupi Gjykses vëren se shumë prej tyre janë të shkruar me dorë dhe në to përshkruhen me hollësi operacionet luftarake në Kosovë dhe në rajonet afër kufirit dhe në përshkrimet e operacioneve përmendet qartë përfshirja e UÇK-së dhe/ose e njësive konkrete gjatë periudhës përkatëse që mbulon Aktakuza. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se të gjitha materialet kanë data. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 61 dhe 68 janë të nënshkruara, provat materiale të propozuara 60, 61 dhe 64 përfshijnë emra të komandantëve përkatës, si komandant “Petriri” ose zyrtarë të tjerë të UÇK-së,

¹¹¹ Provat materiale të propozuara 56, 74, 77, 78, 90 dhe 93.

¹¹² *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, në pjesët përkatëse.

¹¹³ Fakti i shqyrtuar 230.

¹¹⁴ Provat materiale të propozuara 57, 58, 60, 61, 64, 68, 70, 89 dhe 95.

pozitat e të cilëve konfirmohen pjesërisht nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes.¹¹⁵ Po kështu, në lidhje me provën materiale të propozuar 61, Trupi Gjykses vëren se në të përmenden fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.¹¹⁶ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për luftimet kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

65. Në lidhje me dokumentet për bashkëpunëtorët,¹¹⁷ Trupi Gjykses vëren se, ndonëse shumica e provave materiale të propozuara janë me shkrim dore, ato të gjitha kanë data, dhe datat përkojnë me periudhën relevante për Aktakuzën. Në këto prova materiale të propozuara përmenden UÇK-ja, UÇK-ja në Prizren ose LDK-ja. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 81 dhe 98 janë të nënshkruara, dhe prova materiale e propozuar 82 ka numër reference. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për bashkëpunëtorët kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

66. Lidhur me dokumentet financiare,¹¹⁸ Trupi Gjykses fillimisht vëren se Mbrojtja kundërshton specifikisht pranimin e provës materiale të propozuar 62 me arsyetimin se: (i) ZPS-ja nuk ka dhënë informacion për autorin e një numri nënshkrimesh që përmban materiali; dhe (ii) autori i supozuar i disa prej nënshkrimeve nuk është dëshmitar në procesin aktual.¹¹⁹ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton se, fakti që në një dokument nuk përmendet burimi, nuk do të thotë se nuk mund të ketë tregues të tjerë të prejardhjes së tij.¹²⁰ Gjithashtu, siç u theksua tashmë, në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara nuk ka një kriter sipas të cilit autenticiteti i provave materiale të propozuara duhet të konfirmohet

¹¹⁵ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, në pjesët përkatëse.

¹¹⁶ *Shih* Faktin e shqyrtuar 263.

¹¹⁷ Provat materiale të propozuara 59, 76, 79, 81, 82, 98.

¹¹⁸ Provat materiale të propozuara 62, 94, 97.

¹¹⁹ Përgjigjja, para. 20; Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 98, prova materiale e propozuar 62.

¹²⁰ *Shih* më lart paragrafin 14.

përmes dëshmitarit.¹²¹ Prova materiale e propozuar 62 përbëhet nga një numër materialesh që kanë data, janë të nënshkruara, kanë emrin e UÇK-së në krye dhe janë hartuar në formularë identikë. Trupi Gjykues është bindur se prova materiale e propozuar 62 është *prima facie* autentike. Në lidhje me pjesën tjetër të dokumenteve financiare, Trupi Gjykues vëren se ato të gjitha kanë data, janë të nënshkruara, kanë emrin e UÇK-së ose emblemën e saj në krye dhe numër reference. Gjithashtu, ato që të gjitha janë përpiluar në formularë standardë zyrtarë, që ngjasojnë me njëri-tjetrin. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se dokumentet financiare kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

67. Në lidhje me dokumentet për masat disiplinore,¹²² Trupi Gjykues thekson se të gjitha provat materiale të propozuara janë me shkrim dore, të gjitha kanë data, dhe datat në to përkojnë me periudhën relevante për Aktakuzën. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 67 dhe 71 janë të nënshkruara dhe në provën materiale të propozuar 71 përmendet UÇK-ja në Prizren. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se, bazuar në përmbajtjen e tyre, dokumentet për masat disiplinore pasqyrojnë faktin se ato lidhen me masat disiplinore për njësitë e UÇK-së. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se dokumentet për masat disiplinore kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

68. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 51-64 dhe 66-98 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykues është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykues është bindur se vlera provuese *prima facie*

¹²¹ Shih më lart paragrafin 12.

¹²² Provat materiale të propozuara 67, 71, 88.

e provave materiale të propozuara 51-64 dhe 66-98 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

69. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 51-64 dhe 66-98 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1) dhe, refuzon, në formë jo të prerë, pranimin e provës materiale të propozuar 65.

5. Provat materiale të propozuara 99-103: Suhareka

(a) Relevanca

70. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 99-103, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) shkallën e organizimit dhe strukturën e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut dhe kontrollin mbi ushtarët e UÇK-së, si dhe me koordinimin brenda njësive të UÇK-së; dhe (ii) natyrën e organizuar të forcave të UÇK-së që vepronin në Suharekë në korrik dhe gusht 1998 dhe aftësitë e UÇK-së për mbajtjen e dokumentacionit.¹²³ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses thekson se provat materiale të propozuara 99, 101 dhe 102 janë leje udhëtimi që autorizojnë udhëtimin e ushtarëve, shënime me shkrim dore dhe/ose fletore që përmbajnë lista ushtarësh të UÇK-së dhe oraret e kujdestarisë së tyre në Suharekë, si dhe detyrat e personelit të UÇK-së. Gjithashtu, prova materiale e propozuar 100 përmban raporte të UÇK-së mbi detyrat e caktuara për t'u kryer në zonë dhe prova materiale e propozuar 103 përmban urdhra të shtabit vendor të UÇK-së në Suharekë në lidhje me logjistikën.

71. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 99-103 për të treguar se: (i) njësitë dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet në zonë, përfshirë Suharekën;¹²⁴ (ii) Zona Operative e Pashtrikut ishte përgjegjëse për sigurimin e

¹²³ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 99-103.

¹²⁴ Mocioni, para. 4.

mallrave dhe furnizimeve të tjera për nevojat e UÇK-së;¹²⁵ dhe (iii) Zona Operative e Pashtrikut bënte koordinimin ndërmjet njësive dhe shtabeve vendore.¹²⁶

72. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 99-103, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.¹²⁷

(b) Autenticiteti

73. Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të provave materiale të propozuara 99-103. Konkretisht, Trupi Gjykses vë në dukje se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data, ose shënimet që përmbajnë kanë data të cilat janë relevante për Aktakuzën;¹²⁸ (ii) janë të nënshkruara ose disa prej shënimeve që përmbajnë janë të nënshkruara;¹²⁹ (iii) kanë emrat e autorëve;¹³⁰ (iv) në to ka përshkrime të hollësishme dhe përmenden veprime të kryera në atë kohë nga njësiti e Zonës Operative të Pashtrikut, ndër to dhe “njësiti Lisi”;¹³¹ dhe (v) janë formularë standardë dhe mbajnë emrin ose fjalët shtabi vendor i UÇK-së në Suharekë në krye.¹³² Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 99-103 janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

74. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 99-103 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e

¹²⁵ Mocioni, para. 14.

¹²⁶ Mocioni, para. 16.

¹²⁷ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 680, 681. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

¹²⁸ Provat materiale të propozuara 99, 100, 101, 102, 103.

¹²⁹ Provat materiale të propozuara 99, 100, 103.

¹³⁰ Prova materiale e propozuar 103.

¹³¹ Provat materiale të propozuara 100, 101, 102.

¹³² Prova materiale e propozuar 103.

provave materiale të propozuara 99-103 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

75. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 99-103 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

6. Provat materiale të propozuara 104-126: Budakova

(a) Relevanca

76. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 104-126, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) organizimin e UÇK-së; (ii) pretendimin për ekzistencën e konfliktit të armatosur; (iii) ekzistencën e një sistemi raportimi të rregullt të rezultateve të zbulimit; (iv) dokumentimin e urdhrave për raportim të mëpasshëm Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; dhe (v) politikën e UÇK-së ndaj bashkëpunëtorëve.¹³³ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 104-106, 109-115 dhe 117-119 janë raporte zbulimi dhe/ose vëzhgimi të UÇK-së ("raportet e zbulimit të UÇK-së"); (ii) prova materiale e propozuar 107¹³⁴ është një listë e ushtarëve të UÇK-së; (iii) prova materiale e propozuar 108 përbëhet nga evidenca të shërbimeve të kryera nga UÇK-ja; (iv) prova materiale e propozuar 116 është një shënim në lidhje me politikën e UÇK-së ndaj atyre që perceptoheshin si bashkëpunëtorë; (v) provat materiale të propozuara 120 dhe 123-126 janë formularë standardë të UÇK-së në Budakovë ("formularët"); (vi) prova materiale e propozuar 121 është një raport mbi mbledhjen e armëve; dhe (vii) prova materiale e propozuar 122 është një plan për mbajtjen e llogarive të UÇK-së në Budakovë.

77. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 104-126 për të treguar se: (i) njësitë dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën

¹³³ Shtojca 1 e Mocionit, f. 80-90, provat materiale të propozuara 104-126.

¹³⁴ Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk kërkon të paraqesë si provë faqen U001-8784.

Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet e tyre në zonë, përfshirë Budakovën;¹³⁵ (ii) Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte pushtet dhe e ushtroi atë në Zonën Operative të Pashtrikut gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza, kjo dhe përmes krijimit të strukturave të raportimit dhe komunikimit;¹³⁶ (iii) komandantët e brigadave dhe batalioneve të Zonës Operative të Pashtrikut dhe komandantët në vartësi të tyre lëshonin dokumente komunikimi të standardizuara;¹³⁷ dhe (iv) anëtarët e brigadës së Zonës Operative të Pashtrikut hetonin, arrestonin dhe/ose shënjestronin bashkëpunëtorët e pretenduar.¹³⁸

78. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 104-107 dhe 109-126, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.¹³⁹

79. Në lidhje me provën materiale të propozuar 108, Trupi Gjykses vëren se kjo është një listë me emra personash për të cilët thuhet se ishin rrobaqepës, relevanca e së cilës për aktivitetet e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut ose në Budakovë, nuk mund të dihet pa kontekstualizimin e duhur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar relevancën e provës materiale të propozuar 108.

(b) Autenticiteti

80. Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të raporteve të zbulimit të UÇK-së.¹⁴⁰ Konkretisht, Trupi Gjykses thekson se këto

¹³⁵ Mocioni, para. 4.

¹³⁶ Mocioni, para. 5.

¹³⁷ Mocioni, para. 18.

¹³⁸ Mocioni, para. 19.

¹³⁹ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 384-389. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

¹⁴⁰ Provat materiale të propozuara 104-106, 109-115, 117-119.

prova materiale të propozuara: (i) kanë data¹⁴¹; (ii) janë të nënshkruara;¹⁴² dhe (iii) në to përshkruhet konkretisht koha kur u kryen aktivitetet e zbulimit,¹⁴³ me referenca të qarta për zonën e Budakovës.¹⁴⁴ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se raportet e zbulimit të UÇK-së¹⁴⁵ kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

81. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të formularëve.¹⁴⁶ Konkretisht, Trupi Gjykses thekson se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë emrin e UÇK-së në krye;¹⁴⁷ (ii) kanë si datë vitin 1998; (iii) i drejtohen komandantit të batalionit;¹⁴⁸ dhe (iv) në to përmendet Budakova.¹⁴⁹ Gjithashtu, në provën materiale të propozuar 120 përfshihet edhe emri i komandantit Sadik Halitjaha, pozita e të cilit konfirmohet nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes.¹⁵⁰

82. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se prova materiale e propozuar 107 është *prima facie* autentike, duke pasur parasysh se, ndonëse pa datë dhe e panënshkruar: (i) ajo ka emrin e UÇK-së në krye dhe në të përmendet komandanti i batalionit, (ii) në të jepen emra ushtarësh me të dhënat personale të tyre, dhe (iii) anëtarësia e disa prej ushtarëve në batalionin 2 të Budakovës konfirmohet edhe nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes gjyqësore.¹⁵¹ Në mënyrë të ngjashme, prova materiale e propozuar 116 ka datë, është e nënshkruar dhe në të evidentohen me emra dhe të dhëna personale individë të dyshuar për bashkëpunim me serbët. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se prova

¹⁴¹ Provat materiale të propozuara 104-106, 109-115, 117-119.

¹⁴² Provat materiale të propozuara 104-106, 109-115, 117-119.

¹⁴³ Provat materiale të propozuara 104-106, 110, 111, 113, 118, 119.

¹⁴⁴ Provat materiale të propozuara 109, 111, 112, 115, 117-119.

¹⁴⁵ Provat materiale të propozuara 104-106, 109-115, 117-119.

¹⁴⁶ Provat materiale të propozuara 120, 123-126.

¹⁴⁷ Provat materiale të propozuara 120, 123-126.

¹⁴⁸ Provat materiale të propozuara 120, 123-126.

¹⁴⁹ Provat materiale të propozuara 120, 123-125.

¹⁵⁰ Shtojca 1 e Mocionit, f. 87, 88, prova materiale e propozuar 120.

¹⁵¹ Shtojca 1 e Mocionit, f. 82, prova materiale e propozuar 107.

materiale e propozuar 116 është *prima facie* autentike. Në lidhje me provën materiale të propozuar 121, Trupi Gjykses thekson se (i) ajo ka datë, (ii) i drejtohet komandantit të batalionit 2 në Budakovë, dhe (iii) në të përshkruhen me hollësi ngjarje të asaj kohe që kanë të bëjnë me UÇK-në. Gjithashtu, ky material u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 121 është *prima facie* autentike.

83. Në lidhje me provën materiale të propozuar 122, Trupi Gjykses vëren se ky dokument nuk është i nënshkruar, nuk i atribuohet ndonjë subjekti apo personi dhe në të nuk ka ndonjë referencë të qartë për UÇK-në; në të përmendet në mënyrë të përgjithshme Budakova. Rrjedhimisht, ZPS-ja nuk ka vërtetuar se prova materiale e propozuar 122 është *prima facie* autentike.

84. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 104-107, 109-121 dhe 123-126 janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

85. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 104-104, 109-121 dhe 123-126 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 104-107, 109-121 dhe 123-126 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

86. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 104-107, 109-121 dhe 123-126 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1) dhe, refuzon, në formë jo të prerë, pranimin e provave materiale të propozuara 108 dhe 122.

7. Provat materiale të propozuara 127-160: Rahoveci

87. Fillimisht, Trupi Gjykses autorizon ZPS-në të zëvendësojë përkthimin e provës materiale të propozuar 155 të paraqitur në Mocion, me përkthimin e rishikuar të saj.¹⁵²

88. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja kërkon tërheqjen e provave materiale të propozuara 130, 146 dhe 156, duke pasur parasysh se ato janë pranuar tashmë.¹⁵³ Trupi Gjykses e deklaron të tejkaluar kërkesën për pranimin e provave materiale të propozuara 130 dhe 146, të pranuar tashmë përkatësisht si P02076 dhe P02077.

89. Lidhur me provën materiale të propozuar 156, gjersa ZPS-ja parashtrohet se ajo është pranuar si provë, që e bën kërkesën për pranimin e saj të tejkaluar, Trupi Gjykses vëren se ajo vetëm është shënuar për evidentim si prova P02078 MFI.

(a) Relevanca

90. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 127-129, 131-145 dhe 147-160, ZPS-ja parashtrohet se ato lidhen me: (i) strukturën e UÇK-së dhe nivelin e lartë të organizimit në Zonën Operative të Pashtrikut; (ii) ekzistencën e një rrjeti komunikimit të unifikuar dhe të standardizuar; (iii) koordinimin në të gjitha njësitë e UÇK-së; (iv) aftësinë e UÇK-së për të kryer procedura disiplinore ndaj anëtarëve të saj; (v) aktivitetet e njësive të UÇK-së në Rahovec; (vi) pushtetin e Sabahajdin Cenës në Rahovec; (vii) zinxhirin komandues; dhe (viii) betejën e Rahovecit.¹⁵⁴ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 127, 129, 131-132, 138 dhe 149 janë ose përfshijnë lista të ushtarëve dhe anëtarëve të UÇK-së në Rahovec dhe/ose në Zonën Operative të Pashtrikut, ("dokumentet për personelin"); (ii) provat materiale të propozuara 133, 136, 139-145, 147, 151-153, 155 dhe 157 janë shënime, deklarata dhe/ose vërtetime të

¹⁵² Kundërpërgjigjja, para. 6.

¹⁵³ Kundërpërgjigjja, para. 6.

¹⁵⁴ Shtojca 1 e Mocionit, f. 91-124, provat materiale të propozuara 127-160.

komandës operative rajonale “Arti” të Zonës Operative të Pashtrikut në Rahovec në lidhje me donacionet dhe fondet e dhëna për UÇK-në (“dokumentet e donacioneve për UÇK-në”); (iii) prova materiale e propozuar 134 është një shënim për riparimin e një automjeti të UÇK-së; (iv) provat materiale të propozuara 135, 137 dhe 156 janë dokumente në lidhje me masat disiplinore ndaj anëtarëve të UÇK-së (“dokumentet për masat disiplinore”); (v) provat materiale të propozuara 128, 138, 148, 150, 154 dhe 158-160 përmbajnë një listë të emrave të koduar që lidhen me pikat e UÇK-së, urdhrat dhe/ose udhëzimet e lëshuara nga zëvendëskomandanti i shtabit operativ rajonal “Arti” në lidhje me operacionet e UÇK-së, shënime në lidhje me konfliktet e brendshme në njësitë e UÇK-së, lista të vizitorëve në shtabin e UÇK-së në Rahovec, deklarata në lidhje me komandantët e UÇK-së në Rahovec dhe deklarata lidhur me strategjitë e UÇK-së në ofensivën e Rahovecit (“dokumentet e operacioneve të UÇK-së”).

91. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 127-129, 131-145 dhe 147-160 për të treguar se: (i) njësitë dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet në zonë, përfshirë në Rahovec;¹⁵⁵ (ii) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut mbante takime të rregullta, ishte përgjegjëse për njësitë e UÇK-së në zonën operative dhe organizonte shpërndarjen e mallrave dhe furnizimeve të tjera për nevojat e UÇK-së;¹⁵⁶ (iii) komandantët e njësive përkatëse koordinoheshin me njësitë e tjera dhe shtabet vendore;¹⁵⁷ dhe (iv) komandantët e brigadave dhe batalioneve dhe komandantët në vartësi të tyre mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët, armatimin dhe aktivitetin e tyre dhe lëshonin dokumente komunikimi të standardizuara.¹⁵⁸

¹⁵⁵ Mocioni, para. 4.

¹⁵⁶ Mocioni, para. 14.

¹⁵⁷ Mocioni, para. 16.

¹⁵⁸ Mocioni, para. 18.

92. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 127-129, 131-145 dhe 147-160, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.¹⁵⁹

(b) Autenticiteti

93. Në lidhje me autenticitetin e dokumenteve për personelin,¹⁶⁰ Trupi Gjykses vëren se në këto prova materiale të propozuara përmendet njësi "Arti" në Rahovec,¹⁶¹ si dhe emrat e komandantëve,¹⁶² pozitat e të cilëve konfirmohen pjesërisht nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes.¹⁶³ Në provën e propozuar 131 përmenden pseudonimet e komandantëve, pozitat e të cilëve në Rahovec konfirmohen edhe nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes.¹⁶⁴ Gjithashtu, provat materiale të propozuara 138 dhe 149 kanë data dhe prova materiale e propozuar 149 është e nënshkruar. Për më tepër, në shikim të parë, këto prova materiale të propozuara duket se janë çka pretendohet të jenë, domethënë, lista të ushtarëve të UÇK-së me të dhënat personale të tyre, ku jepen hollësi të aktiviteteve ditore të tyre dhe armatimit të dhënë. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për personelin¹⁶⁵ kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

94. Në lidhje me dokumentet e donacioneve për UÇK-në,¹⁶⁶ Trupi Gjykses vëren se ato janë të nënshkruara,¹⁶⁷ kanë data,¹⁶⁸ në to përmenden emrat e autorëve të tyre dhe komanda operative rajonale "Arti" në Rahovec.¹⁶⁹ Gjithashtu, Trupi

¹⁵⁹ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 338, 635, 636. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

¹⁶⁰ Provat materiale të propozuara 127, 129, 131, 132, 138, 149.

¹⁶¹ Provat materiale të propozuara 127, 129, 131, 132, 138, 149.

¹⁶² Provat materiale të propozuara 127, 129, 138.

¹⁶³ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, në pjesët përkatëse.

¹⁶⁴ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 94, 95, provën materiale të propozuar 131.

¹⁶⁵ Provat materiale të propozuara 127, 129, 131, 132, 138, 149.

¹⁶⁶ Provat materiale të propozuara 133, 136, 139-145, 147, 151-153, 155, 157.

¹⁶⁷ Provat materiale të propozuara 133, 136, 139-145, 147, 151-153, 155, 157.

¹⁶⁸ Provat materiale të propozuara 133, 136, 139-145, 147, 151-153, 155, 157.

¹⁶⁹ Provat materiale të propozuara 133, 136, 139-145, 147, 151-153, 155, 157.

Gjykues thekson se provat materiale të propozuara 145 dhe 152 janë të nënshkruara nga komandanti Sabahajdin Cena, roli i të cilit në UÇK në Rahovec është konfirmuar edhe nga W00498.¹⁷⁰ Po kështu, prova materiale e propozuar 153 është e nënshkruar nga Ismet Tara, i cili konfirmoi rolin e tij në UÇK në Rahovec gjatë dëshmisë që dha.¹⁷¹ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet e donacioneve për UÇK-së¹⁷² kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

95. Lidhur me provën materiale të propozuar 134, Trupi Gjykses vëren se shumica e informacionit jepet në formularë standardë, çdo material që përmban është i nënshkruar, është dhënë numri i referencës, data dhe në të përmendet shtabi vendor i UÇK-së. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 134, ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

96. Në lidhje me dokumentet për masat disiplinore,¹⁷³ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara janë të nënshkruara, kanë datë dhe në to përmendet shtabi operativ rajonal "Arti" në Rahovec. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se, në shikim të parë, këto prova materiale të propozuara janë çka pretendohet të jenë, domethënë dokumente për masat disiplinore ndaj anëtarëve të UÇK-së në Rahovec. Po kështu, në lidhje me provën materiale të propozuar 135, Trupi Gjykses vëren se në të përmenden fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor¹⁷⁴ dhe se prova materiale e propozuar 156 u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të

¹⁷⁰ Transkripti i seancës, 20 shkurt 2024, f. 12527, rreshtat 4-6.

¹⁷¹ Transkripti i seancës, 24 shkurt 2025, f. 25481, rreshtat 1-3.

¹⁷² Provat materiale të propozuara 127, 129, 131, 132, 138, 149.

¹⁷³ Provat materiale të propozuara 135, 137, 156.

¹⁷⁴ Faktet e shqyrtuara 456-467.

propozuara 135, 137 dhe 156 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

97. Në lidhje me dokumentet e operacioneve të UÇK-së,¹⁷⁵ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) janë të nënshkruara;¹⁷⁶ (ii) kanë data;¹⁷⁷ (iii) në to ka referenca të qarta për UÇK-në në Rahovec;¹⁷⁸ (iv) në to përmenden emra të komandantëve të UÇK-së në Rahovec;¹⁷⁹ dhe (v) në to përmenden ngjarje të asaj kohe në lidhje me veprimet luftarake në Rahovec.¹⁸⁰ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 128, 148, 150, 154 dhe 158-160 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

98. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 127-129, 131-145 dhe 147-160 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 127-129, 131-145 dhe 147-160 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

99. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 127-129, 131-145 dhe 147-160 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

¹⁷⁵ Provat materiale të propozuara 128, 148, 150, 154, 158-160.

¹⁷⁶ Provat materiale të propozuara 148, 150, 154, 158.

¹⁷⁷ Provat materiale të propozuara 148, 150, 154, 158-160.

¹⁷⁸ Provat materiale të propozuara 148, 150, 154, 158.

¹⁷⁹ Provat materiale të propozuara 158-160.

¹⁸⁰ Provat materiale të propozuara 158-160.

100. Pasi ka konstatuar se prova materiale e propozuar 156 është e pranueshme, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative që të pasqyrojë statusin e provës P02078 MFI si provë e pranuar.

8. Provat materiale të propozuara 161-172: Ratkoci

101. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja kërkon tërheqjen e kërkesës për pranim të provave materiale të propozuara 167 dhe 169, duke qenë se ato tashmë janë pranuar si provat P02045 dhe P02044 pas paraqitjes së Mocionit.¹⁸¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e deklaron të tejkaluar kërkesën për pranimin e provave materiale të propozuara 167 dhe 169.

(a) Relevanca

102. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 161-166, 168 dhe 170-172, ZPS-ja parashtrohet se ato lidhen me: (i) ekzistencën e një sistemi rekrutimi të UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut; (ii) praninë e UÇK-së në Ratkoc dhe në komunën e Rahovecit; (iii) sistemin e raportimit të mosmarrëveshjeve të brendshme shtabit të UÇK-së; dhe (iv) aftësinë e policisë ushtarake të UÇK-së për të arrestuar dhe ndaluar civilë të dyshuar për bashkëpunim.¹⁸² Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: provat materiale të propozuara 161,162, 164-166, 168, 170 dhe 171 janë: (i) leje udhëtimi, lista të vullnetarëve të UÇK-së, lista të ushtarëve të kompanisë së dytë në Ratkoc dhe njësitit Dejani, certifikata mjekësore të ushtarëve ("dokumentet për personelin"); (ii) prova materiale e propozuar 163 është deklaratë e një ushtari të UÇK-së në lidhje me një mosmarrëveshje të brendshme; dhe (iii) prova materiale e propozuar 172 është një listë e automjeteve të kompanisë së dytë të UÇK-së në Ratkoc.

103. ZPS-ja gjithashtu mbështetet në provat materiale të propozuara 161-166, 168 dhe 170-172 për të treguar se: (i) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut

¹⁸¹ Kundërpërgjigjja, para. 6.

¹⁸² Shtojca 1 e Mocionit, f. 125-134, provat materiale të propozuara 161-172.

koordinohet me zonat e tjera operative dhe merrte masa për rekrutimin, trajnimin dhe sistemimin e ushtarëve të rinj;¹⁸³ (ii) ajo mbante evidenca të hollësishme për anëtarët, armatimin dhe aktivitetet e tyre; (iii) komandantët e brigadave dhe batalioneve dhe komandantët në vartësi të tyre lëshonin dokumente komunikimi të standardizuara;¹⁸⁴ dhe (iv) anëtarët e brigadës së Zonës Operative të Pashtrikut hetonin, arrestonin dhe ndalonin bashkëpunëtorë të pretenduar.¹⁸⁵

104. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 161-166, 168 dhe 170-172, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.¹⁸⁶

(b) Autenticiteti

105. Në lidhje me autenticitetin e dokumenteve për personelin,¹⁸⁷ Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara: (i) kanë data;¹⁸⁸ (ii) në to jepen emrat e ushtarëve dhe të dhënat personale të tyre;¹⁸⁹ (iii) janë të nënshkruara;¹⁹⁰ (iv) në to përmenden detyrat e ushtarëve të UÇK-së në vendet e caktuara, që edhe përshkruhen brenda dokumenteve;¹⁹¹ dhe (v) në to përmendet UÇK-ja në Ratkoc.¹⁹² Gjithashtu, në lidhje me provën materiale të propozuar 164, Trupi Gjykses thekson se ajo përmban fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.¹⁹³ Po kështu, përmbajtja e provës materiale të propozuar 162 është e përfshirë në formularët e standardë të UÇK-së në Ratkoc dhe ka numra reference. Bazuar në sa

¹⁸³ Mocioni, para. 14.

¹⁸⁴ Mocioni, para. 18.

¹⁸⁵ Mocioni, para. 19.

¹⁸⁶ Aktakuza, para. 18-55, 152; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 273-276, 279, 356, 339. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

¹⁸⁷ Provat materiale të propozuara 161, 162, 164-166, 168, 170, 171.

¹⁸⁸ Provat materiale të propozuara 161, 162, 164, 165, 168, 170, 171.

¹⁸⁹ Provat materiale të propozuara 161, 165, 168, 170.

¹⁹⁰ Provat materiale të propozuara 162, 164, 165, 168, 170, 171.

¹⁹¹ Provat materiale të propozuara 161, 165, 168, 170, 171.

¹⁹² Provat materiale të propozuara 162, 164, 165, 168, 170, 171.

¹⁹³ Faktet e shqyrtuara 462-463.

më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 161,162, 164-166, 168, 170 dhe 171 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

106. Në lidhje me provën materiale të propozuar 163, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse shënimi me shkrim dore nuk është i nënshkruar, ai i atribuohet një personi të dhënat personale të të cilit janë gjithashtu të përfshira në dokument. Në shikim të parë, informacioni lidhur me masat disiplinore ndaj personit të përmendur në të është dhënë me hollësi të mjaftueshme. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 163 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

107. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se prova materiale e propozuar 172 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti, duke qenë se është e nënshkruar, ka datë dhe referenca të qarta për komandën e kompanisë së dytë të UÇK-së në Ratkoc.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

108. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 161-166, 168 dhe 170-172 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 161-166, 168 dhe 170-172 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

109. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 161-166, 168 dhe 170-172, janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

9. Provat materiale të propozuara 173-177: Drenoci

(a) Relevanca

110. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 173-177,¹⁹⁴ ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) aftësinë e UÇK-së për të komunikuar dhe standardizuar komunikimet dhe udhëzimet e saj; (ii) shkallën e organizimit të UÇK-së në Drenoc; dhe (iii) politikën e UÇK-së ndaj kundërshtarëve dhe ekzistencën e qëllimit kriminal të përbashkët.¹⁹⁵ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se provat materiale të propozuara 173-177 janë udhëzime operative ku përfshihen kode komunikimi/thirrjesh, shënime me shkrim dore në lidhje me ushtrimet ushtarake, dhe shënime e deklarata me shkrim dore lidhur me bashkëpunëtorët e dyshuar dhe marrjen në pyetje të personave të ndaluar.

111. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar se: (i) njësitet dhe anëtarët e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut bashkërendonin operacionet në zonat nën kontrollin e tyre, përfshirë Drenocin dhe zonën rreth tij;¹⁹⁶ dhe (ii) komandantët e brigadave dhe batalioneve dhe komandantët në vartësi të tyre lëshonin dokumente komunikimi të standardizuara dhe përgatisnin oficerët në përputhje urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.¹⁹⁷

112. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 173-177, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.¹⁹⁸

¹⁹⁴ Në lidhje me provën materiale të propozuar 175, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk paraqet për pranim pjesët në vijim: U017-3055-U017-3078/U017-3055-U017-3078-ET, f. U017-3058-U017-3065, U017-3068; U017-3071-U017-3074, U017-3077 dhe U017-3078.

¹⁹⁵ Shtojca 1 e Mocionit, f. 135-140.

¹⁹⁶ Mocioni, para. 4.

¹⁹⁷ Mocioni, para. 18.

¹⁹⁸ Aktakuza, para. 18-55, 148; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 228, 338-345, 351. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

(b) Autenticiteti

113. Lidhur me autenticitetin, Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara 173 dhe 174 janë udhëzime të daktilografuara për radiokomunikimet dhe kodet e thirrjeve. Ndonëse këto materiale nuk janë të nënshkruara apo të vulosura, Trupi Gjykses gjykon se në to përmenden qartë komandantë të UÇK-së në Drenoc, si "Gjermani" ose "Ganiu", ose vende ku ishte UÇK-ja në atë zonë, si Ratkoci. Trupi Gjykses është i mendimit se autenticiteti i dokumenteve konfirmohet më tej nga dëshmitë e dëshmitarëve¹⁹⁹ si dhe nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes.²⁰⁰ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 173 dhe 174 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

114. Në lidhje me provën materiale të propozuar 175, Trupi Gjykses vëren se ajo ka datë, është e nënshkruar, ka numra reference dhe në të përmenden aktivitete të asaj kohe të UÇK-së në Drenoc, si dhe anëtarë të saj, të dhënat personale të të cilëve jepen në dokument. Në lidhje me provat materiale të propozuara 176 dhe 177, Trupi Gjykses thekson se ato janë të nënshkruara, kanë datë, dhe emrat e autorëve të tyre janë dhënë në dokument. Gjithashtu, në lidhje me provën materiale të propozuar 176, Trupi Gjykses thekson se në të përmenden fakte që janë përmendur në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.²⁰¹ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 175-177 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

115. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 173-177 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë

¹⁹⁹ Shih Shtojcën 1 të Mocionit, f. 135, 136, provat materiale të propozuara 173, 174.

²⁰⁰ Shih p.sh., P00011.

²⁰¹ Faktet e shqyrtuara 464, 465.

gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 173-177 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

116. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 173-177 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

10. Provat materiale të propozuara 178-209: Brigada 121

117. ZPS-ja kërkon tërheqjen e kërkesës për pranimin e provës materiale të propozuar 206, sepse ajo u pranua si prova P02019 pasi ishte dorëzuar Mocioni.²⁰² Rrjedhimisht Trupi Gjykses e deklaroi të tejkaluar kërkesën për pranimin e provës materiale të propozuar 206.

(a) Relevanca

118. Lidhur me relevancën e provave materiale të propozuara 178-205 dhe 207-209, ZPS-ja parashtroi se ato lidhen me: (i) shkallën e organizimit, strukturën dhe kontrollin e UÇK-së mbi anëtarët e saj dhe koordinimin ndërmjet njësive; (ii) ekzistencën e rregulloreve të funksionimit të njësive të policisë ushtarake të UÇK-së; (iii) praktikën e UÇK-së për identifikimin dhe hetimin e personave të dyshuar për bashkëpunim; (iv) zbatimin e masave disiplinore prej UÇK-së ndaj anëtarëve të saj; (v) marrëdhëniet ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe Brigadës 121; (vi) ekzistencën e konfliktit të armatosur; (vii) krimet në Zonën Operative të Pashtrikut për të cilat u ngritën akuza, si dhe ekzistencën e qëllimit kriminal të përbashkët të pretenduar; dhe (viii) zinxhirin komandues në nivel brigade dhe batalioni.²⁰³ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat

²⁰² Kundërpërgjigjja, para. 6.

²⁰³ Shtojca 1 e Mocionit, f. 141-164, provat materiale të propozuara 178-205, 207-209.

materiale të propozuara 178, 180,²⁰⁴ 184, 185, 189, 195, 197, 203, 204, 207 dhe 208 janë orare ditore, rregulla dhe veprimtari rutinë të anëtarëve të Brigadës 121, shënime mbi përgatitjen taktike të ushtarëve, urdhra për kryerjen e detyrave ushtarake, kërkesa të bëra nga Brigada 121 për imunizimin e ushtarëve të brigadës dhe orare të kujdestarisë; (ii) provat materiale të propozuara 182, 183, 190, 198,²⁰⁵ dhe 199 janë evidenca të shpenzimeve dhe furnizimeve për ushtarët, kërkesa për kompensim, fatura për furnizime të dhuruara UÇK-së, urdhra në lidhje me inventarizimin e automjeteve dhe municionit (“dokumentet e furnizimeve”); (iii) provat materiale të propozuara 186, 187, 191, 193,²⁰⁶ 200 dhe 202 janë urdhra dhe shënime me shkrim dore në lidhje me lëvizjen e trupave, caktimin e anëtarëve në aksione luftarake, udhëzime në lidhje me ofensivën e UÇK-së dhe raporte të patrullimit (“dokumentet e operacioneve”); (iv) provat materiale të propozuara 179,²⁰⁷ 181, 192 dhe 201 janë shënime me shkrim dore në lidhje me individë të dënuar ose të akuzuar për aktivitet kriminal, urdhra në lidhje me riorganizimin dhe ndarjen e zonave të përgjegjësisë së batalioneve, që i referohen procedurave të Rregullores së Disiplinës të UÇK-së, betimit ushtarak dhe procesverbaleve të takimeve ku diskutohej zbatimi i rregullave të disiplinës nga ushtarët e Brigadës 121 (“dokumentet e disiplinës”); (v) provat materiale të propozuara 188,²⁰⁸ 196 dhe 205 janë lista të personave të burgosur; dhe (vi) prova materiale e propozuar 209 është një zarf që duket se më parë ka pasur brenda një telegram që i adresohet z. Selimi.

²⁰⁴ Trupi Gjykses vëren se f. U001-8514-U001-8514 është pranuar përmes W04590-ës si prova P01693/P01693_ET. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 143, prova materiale e propozuar 180.

²⁰⁵ Në lidhje me provën materiale të propozuar 198, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk kërkon pranimin si provë të f. U000-6034.

²⁰⁶ Trupi Gjykses vëren se f. U000-5985 është pranuar si prova P02016.

²⁰⁷ Lidhur me provën materiale të propozuar 179, Trupi Gjykses thekson se ajo është shënuar më parë për identifikim si prova P01123 MFI.

²⁰⁸ Në lidhje me provën materiale të propozuar 188, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk kërkon pranimin si provë të faqes së fundit të këtij dokumenti duke qenë se ajo tashmë është pranuar si prova P00259.

119. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar se: (i) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut mbante takime të rregullta, ishte përgjegjëse për njësitë e UÇK-së në zonën operative dhe në kontakt të rregullt me Shtabin e Përgjithshëm;²⁰⁹ (ii) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut bënte raporte të cilat më pas i zbatonte dhe ua shpërndante komandave vartëse;²¹⁰ (iii) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut koordinohet edhe me zonat e tjera operative dhe merrte masa për rekrutimin, trajnimin dhe dislokimin e ushtarëve të rinj;²¹¹ (iv) komandantët e njësive dhe shtabeve të UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut organizonin ceremonitë e betimit të UÇK-së dhe administrojnë e shpërndanin armë dhe furnizime;²¹² (v) komandantët e brigadave dhe batalioneve u shpërndanin fonde dhe furnizime shtabeve vendore;²¹³ (vi) komandantët e brigadave dhe batalioneve përgatisnin oraret e veprimtarive ditore të ushtarëve të tyre, mbanin evidenca të hollësishme të anëtarëve, armatimit dhe aktiviteteve si dhe trajnonin oficerët në përputhje me urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm;²¹⁴ (vii) komandantët e brigadave dhe batalioneve paralajmëronin se për mosbindje ose moszbatim të urdhrave do të merreshin masa disiplinore;²¹⁵ (viii) policia ushtarake përgjigjej për disiplinën në radhët e UÇK-së dhe kryente funksionet e policisë civile në zonat nën kontrollin e saj;²¹⁶ dhe (ix) policia ushtarake ishte e përfshirë rregullisht dhe përgjegjëse për identifikimin, arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të kundërshtarëve.²¹⁷

²⁰⁹ Mocioni, para. 14.

²¹⁰ Mocioni, para. 14.

²¹¹ Mocioni, para. 14.

²¹² Mocioni, para. 18.

²¹³ Mocioni, para. 18.

²¹⁴ Mocioni, para. 16.

²¹⁵ Mocioni, para. 16.

²¹⁶ Mocioni, para. 22, 25.

²¹⁷ Mocioni, para. 22.

120. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 178-205 dhe 207-209, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.²¹⁸

(b) Autenticiteti

121. Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të dokumenteve për personelin.²¹⁹ Konkretisht, Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë datë;²²⁰ (ii) shumë prej tyre janë të nënshkruara ose kanë vendin për vënien e nënshkrimit të autorit;²²¹ (iii) përmendin shprehimisht UÇK-në ose Brigadën 121;²²² dhe (iv) kanë emrat e ushtarëve me të dhënat personale dhe detyrat e caktuara.²²³ Gjithashtu, prova materiale e propozuar 184 u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi.

122. Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të dokumenteve të furnizimeve.²²⁴ Në veçanti, Trupi Gjykses thekson se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data;²²⁵ (ii) janë të nënshkruara prej autorit të evidentuar në to;²²⁶ (iii) në to përmendet Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, UÇK-ja ose komandanti i njësisë përkatëse;²²⁷ ose (iv) kanë numër reference.²²⁸ Gjithashtu, prova materiale e propozuar 182 u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi.

123. Lidhur me dokumentet e operacioneve,²²⁹ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) përshkruajnë me hollësi operacionet ushtarake të asaj

²¹⁸ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 491. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

²¹⁹ Provat materiale të propozuara 178, 180, 184, 185, 189, 195, 197, 203, 204, 207, 208.

²²⁰ Provat materiale të propozuara 178, 180, 184, 185, 189, 195, 197, 203, 204.

²²¹ Provat materiale të propozuara 178, 184, 189, 195, 204, 207, 208.

²²² Provat materiale të propozuara 178, 180, 184, 185, 189, 195, 197, 203, 204.

²²³ Provat materiale të propozuara 178, 180, 184, 185, 189, 195, 197, 203, 204, 207, 208.

²²⁴ Provat materiale të propozuara 182, 183, 190, 198, 199.

²²⁵ Provat materiale të propozuara 182, 183, 190, 198, 199.

²²⁶ Provat materiale të propozuara 182, 183, 190, 198, 199.

²²⁷ Provat materiale të propozuara 182, 183, 190, 198, 199.

²²⁸ Provat materiale të propozuara 182, 190, 199.

²²⁹ Provat materiale të propozuara 186, 187, 191, 193, 200, 202.

kohe të UÇK-së, përfshirë orën dhe datën e operacionit përkatës;²³⁰ (ii) janë të nënshkruara ose kanë emrin e autoritetit lëshues në dokument;²³¹ (iii) kanë datë;²³² dhe (iv) në to përmendet Brigada 121 si dhe emrat e komandantëve përkatës.²³³ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 186, 187, 191, 193, 200 dhe 202 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

124. Në lidhje me dokumentet e disiplinës,²³⁴ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data;²³⁵ (ii) janë të nënshkruara dhe/ose kanë emrin e autorit të tyre;²³⁶ (iii) në to ka referenca për UÇK-në, togat ose komandantët përkatës;²³⁷ dhe (iv) në to përmenden individë, të dhënat personale të të cilëve jepen brenda dokumenteve.²³⁸ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 179, 181, 192 dhe 201 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

125. Lidhur me provat materiale të propozuara 188, 196 dhe 205, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja parashtro se këto materiale janë shënime me shkrim dore me emra të individëve të burgosur në burgun e Kleçkës.²³⁹ Ndonëse materialet janë shkruar me dorë dhe nuk kanë datë ose nënshkrimin e autorit, Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara 196 dhe 205 janë pjesë të provave materiale të pranuar më parë.²⁴⁰ Gjithashtu, tashmë janë pranuar si prova deklarata të ndryshme të autorit të supozuar të këtyre shënimeve me shkrim dore që konfirmojnë pjesërisht këto dokumente, dhe një prej individëve të përmendur

²³⁰ Provat materiale të propozuara 186, 187, 191, 193, 200, 202.

²³¹ Provat materiale të propozuara 186, 191, 193, 202.

²³² Provat materiale të propozuara 186, 187, 191, 193, 200, 202.

²³³ Provat materiale të propozuara 186, 187, 191, 193, 200, 202.

²³⁴ Provat materiale të propozuara 179, 181, 188, 192, 201.

²³⁵ Provat materiale të propozuara 179, 188, 192, 201.

²³⁶ Provat materiale të propozuara 179, 181, 201.

²³⁷ Provat materiale të propozuara 179, 192.

²³⁸ Provat materiale të propozuara 179, 181.

²³⁹ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 155, 161, provat materiale të propozuara 196, 205.

²⁴⁰ *Shih* P00986 dhe P00987.

është mes viktimave në këtë çështje.²⁴¹ Trupi Gjykses vëren se një pjesë e këtij informacioni përmendet edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.²⁴² Në këtë kontekst, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 196 dhe 205 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

126. Në lidhje me provën materiale të propozuar 209, Trupi Gjykses vëren se ky material është një zarf, që, sipas ZPS-së, ka pasur brenda një telegram për z. Selimi.²⁴³ Trupi Gjykses vëren se zarfi është shënuar me numrin “10”, që sipas informacioneve, ishte pseudonimi i z. Selimi, dhe se telegrami është pranuar si prova P02014. Edhe ky material u sekuestrua në shtëpinë e z. Selimi.²⁴⁴ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 209 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

127. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 178-205 dhe 207-209 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 178-205 dhe 207-209 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

128. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 178-205 dhe 207-209 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1). Pasi ka konstatuar se prova materiale e propozuar 179 është e pranueshme, Trupi

²⁴¹ *Shih* Dosjen Paraprake të ZPS-së, para. 492.

²⁴² Fakti i shqyrtuar 554.

²⁴³ Shtojca 1 e Mocionit, f. 164, prova materiale e propozuar 209.

²⁴⁴ Shtojca 1 e Mocionit, f. 164, prova materiale e propozuar 209.

Gjykues gjithashtu udhëzon Zyrën Administrative që të pasqyrojë statusin e provës P01123 MFI si provë e pranuar.

11. Provat materiale të propozuara 210-222: Brigada 122

(a) Relevanca

129. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 210-222, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) hierarkinë dhe strukturën ushtarake të komandës së Zonës Operative të Pashtrikut dhe Brigadës 122; (ii) paraqitjen e kërkesave brenda Brigadës 122 sipas zinxhirit komandues; (iii) politikën e UÇK-së ndaj bashkëpunëtorëve të dyshuar; (iv) strukturën, organizimin dhe kontrollin efektiv të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; dhe; (v) rolin e komandantëve të Brigadës 122 në kuadër të UÇK-së.²⁴⁵ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vëren se: (i) provat materiale të propozuara 210-213, 220 dhe 222 janë kërkesa për furnizime nga komandantë të togave të Brigadës 122; (ii) prova materiale e propozuar 214 është një raport zbulimi në lidhje me hetime të brendshme; (iii) prova materiale e propozuar 215 është një urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së i nënshkruar prej z. Krasniqi, që i adresohet komandës së Brigadës 122; (iv) provat materiale të propozuara 216,²⁴⁶ 219 dhe 221 janë leje udhëtimi; dhe (v) provat materiale të propozuara 217 dhe 218 janë dokumente ku përshkruhet zinxhiri komandues, detyrat e komandantëve të skuadrave dhe detyrat e ushtarëve.

130. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar se: (i) Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte dhe ushtronte kontroll në Zonën Operative të Pashtrikut, përfshirë përmes zbatimit të rregullave dhe rregulloreve;²⁴⁷ (ii) komandantët e brigadave dhe batalioneve

²⁴⁵ Shtojca 1 e Mocionit, f. 165-173, provat materiale të propozuara 210-221.

²⁴⁶ Trupi Gjykues vë në dukje se f. U000-5837 është pranuar si prova P01697. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 169, prova materiale e propozuar 216.

²⁴⁷ Mocioni, para. 5.

koordinoheshin me njësitë e zonave të tjera operative, transferonin dhe kërkonin ushtarë;²⁴⁸ dhe (iii) komandantët e brigadave dhe batalioneve paralajmëronin se për mosbindje ose moszbatim të urdhrave do të merreshin masa disiplinore.²⁴⁹

131. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 210-222, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.²⁵⁰

(b) Autenticiteti

132. Në lidhje me autenticitetin e provave materiale të propozuara 210-213, 220 dhe 222, Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara: (i) kanë data;²⁵¹ (ii) janë të nënshkruara nga komandantët përkatës të togave të Brigadës 122,²⁵² rolet e të cilëve në UÇK konfirmohen nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes;²⁵³ dhe (iii) në to ka referenca të qarta për UÇK-në dhe/ose Brigadën 122.²⁵⁴ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se të gjitha këto prova materiale të propozuara janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 210-213, 220 dhe 222 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

133. Në lidhje me provën materiale të propozuar 214, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse nuk është e nënshkruar, në të përmendet autori i dokumentit, ajo ka datë, dhe përmban një referencë për UÇK-në, konkretisht për Brigadën 122. Gjithashtu, në këtë provë materiale të propozuar përmenden ngjarje që ndodhën në kohën përkatëse gjatë veprimeve luftarake të UÇK-së.

²⁴⁸ Mocioni, para. 18.

²⁴⁹ Mocioni, para. 18.

²⁵⁰ Aktakuza, para. 18-55. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

²⁵¹ Provat materiale të propozuara 210-213, 220, 222.

²⁵² Provat materiale të propozuara 210-213, 220, 222.

²⁵³ Shtojca 1 e Mocionit, f. 165, 166, 171, 172, provat materiale të propozuara 210-213, 220, 222.

²⁵⁴ Provat materiale të propozuara 210-213, 220, 222.

134. Në lidhje me provën materiale të propozuar 215, Trupi Gjykses thekson se ajo: (i) është një urdhëresë e daktilografuar; (ii) ka fjalët Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në krye; (iii) ka vulën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; dhe (iv) është e nënshkruar prej z. Krasniqi, nënshkrimi i të cilit është konfirmuar nga provat e tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes.²⁵⁵ Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja kundërshton pranimin si provë të këtij materiali, për shkak se është nënshkruar prej z. Krasniqi. Sipas Mbrojtjes, gjithçka që pretendohet se ka për autorë të akuzuarit, është me rëndësi kyçe për çështjen.²⁵⁶ Megjithatë, Trupi Gjykses rikujton se rëndësia kyçe e provave materiale të propozuara për argumentet e Prokurorisë nuk përbën pengesë për pranimin e tyre si prova jोगojore.²⁵⁷

135. Lidhur me provat materiale të propozuara 216, 219 dhe 221, Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) janë të gjitha të nënshkruara; (ii) kanë data; (iii) përmbajnë referenca për UÇK-në; dhe (iv) kanë emrin e UÇK-së në krye dhe numra reference. Gjithashtu, prova materiale e propozuar 216 përfshin një numër lejesh udhëtimi, të përpiluara sipas një formulari zyrtar standard. Në lidhje me provat materiale të propozuara 217 dhe 218, Trupi Gjykses vë në dukje se të dy këto prova materiale: (i) janë të nënshkruara nga komandanti i batalionit të Parë të Brigadës 122; (ii) kanë data; (iii) kanë numra reference; dhe (iv) përmendin UÇK-në dhe Brigadën 122. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 214-219 dhe 221 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

136. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 210-222 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë

²⁵⁵ *Shih p.sh.* P01105, P00623, P01424, P01415.

²⁵⁶ Përgjigja, para. 7; Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 350-353, prova materiale e propozuar 215.

²⁵⁷ *Shih* më lart paragrafin 12.

gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 210-222 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

137. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 210-222 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

12. Provat materiale të propozuara 223-232: Brigada 123

138. ZPS-ja kërkon tërheqjen e kërkesës për pranimin e provës materiale të propozuar 231, sepse ajo u pranua si prova 1D00020 pas dorëzimit të Mocionit.²⁵⁸ Trupi Gjykses vëren se numri i regjistrimit si provë i provës materiale të propozuar 231 është i ndryshëm²⁵⁹ nga ai i 1D00020-ës. Sidoqoftë, pas rishikimit, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet janë kopje të njëri-tjetrit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e deklaron të tejkaluar kërkesën për pranimin e provës materiale të propozuar 231.

(a) Relevanca

139. Në lidhje me provat materiale të propozuara 223-230 dhe 232, ZPS-ja parashtrohet se ato lidhen me: (i) pushtetin e komandantit të batalionit në Brigadën 123; (ii) organizimin, hierarkinë dhe strukturën e UÇK-së dhe Brigadës 123 në Zonën Operative të Pashtrikut; (iii) funksionet dhe përgjegjësitë e Brigadës 123 në lidhje me lëshimin e lejeve të udhëtimit, formularëve të standardizuar, ose me aftësinë e saj për të kryer hetime; dhe (iv) marrëdhënien ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në lidhje me Brigadën 123.²⁶⁰ Në

²⁵⁸ Kundërpërgjigjja, para. 6.

²⁵⁹ *Krahaso* U000-6713-U000-6714 dhe SITF00032906-SITF00032918, f. SITF00032916-SITF00032917.

²⁶⁰ Shtojca 1 e Mocionit, f. 174-181, provat materiale të propozuara 223-232.

lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren gjithashtu se: (i) provat materiale të propozuara 223, 225 dhe 232 janë regjistra ose lista të ushtarëve të UÇK-së në kuadër të Brigadës 123 si dhe leje udhëtimi të tyre; (ii) prova materiale e propozuar 224 është një evidencë e furnizimeve për automjetet; (iii) prova materiale e propozuar 226 është një urdhër i komandantit të Brigadës 123 në lidhje me dorëzimin e gjëseneve për nevojat e UÇK-së; (iv) provat materiale të propozuara 227 dhe 228 janë deklarata në lidhje me hetimet e kryera nga ZKZ-ja; (v) prova materiale e propozuar 229 është një shënim me shkrim dore për një takim midis Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Ministrisë në Mërgim dhe një anëtarit të Brigadës 123; dhe (vi) prova materiale e propozuar 230 është një raport organizativ i komandantit të batalionit të 2-të të Brigadës 123.²⁶¹

140. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar, ndër të tjera, se komandantët e brigadave dhe batalioneve mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët dhe armatimin e tyre.²⁶²

141. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 223-230 dhe 232, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.²⁶³

(b) Autenticiteti

142. Në lidhje me autenticitetin e provave materiale të propozuara 223, 225 dhe 232, Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara janë të nënshkruara, kanë data dhe në to përmenden UÇK-ja dhe komanda e Brigadës 123. Lidhur me provën materiale të propozuar 232, ndonëse Trupi Gjykses vëren se ky material nuk është i nënshkruar dhe nuk ka datë, në të renditen individë me

²⁶¹ Në lidhje me provën materiale të propozuar 230, Trupi Gjykses thekson se materiali SPOE0026707-SPOE0026708 është pranuar si prova 1D00073/1D00073_ET; dhe faqet SPOE0026714-SPOE0026715 janë pranuar si prova 4D00014/4D00014_ET.

²⁶² Mocioni, para. 18.

²⁶³ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 384-387 *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

të dhënat personale të tyre, armët dhe municionet e marra dhe anëtarësia e tyre në Brigadën 123, dhe këto të dhëna konfirmohen pjesërisht dhe nga prova të tjera të paraqitura në Mocion.²⁶⁴ Në lidhje me provën materiale të propozuar 224, Trupi Gjykses vëren se ajo ka datë dhe përmbajtja e saj konfirmohet pjesërisht nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes. Gjithashtu, prova materiale e propozuar 226 përmban referenca për UÇK-në dokument, ka emrin e UÇK-së në krye me një numër reference, dhe ka datë e është e nënshkruar. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se provat materiale të propozuara 227 dhe 228 kanë datë, janë të nënshkruara, kanë emrin e UÇK-së në krye dhe i janë dhënë KFOR-it nga UÇK-ja.²⁶⁵ Lidhur me provën materiale të propozuar 229, Trupi Gjykses thekson se, ndonëse është e panënshkruar dhe pa datë, në të përshkruhet me hollësi një takim ndërmjet UÇK-së dhe Qeverisë në Mërgim në vitin 1998, përmbajtja e së cilës konfirmohet nga prova të tjera në dokumentacionin e çështjes. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se ky material u sekuestrua në shtëpinë e z. Krasniqi. Lidhur me provën materiale të propozuar 230, Trupi Gjykses thekson se ajo ka datë, autorësia e dokumentit u konfirmua nga W04765,²⁶⁶ dhe ajo u sekuestrua në shtëpinë e z. Selimi. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 223-230 dhe 232 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

143. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 223-230 dhe 232 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie*

²⁶⁴ Shtojca 1 e Mocionit, f. 180, prova materiale e propozuar 232.

²⁶⁵ Mocioni, poshtëshënimi 112.

²⁶⁶ Transkripti i seancës, 16 nëntor 2023, f. 10236.

e provave materiale të propozuara 223-230 dhe 232 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

144. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 223-230 dhe 232 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

13. Provat materiale të propozuara 233-264: Brigada 124

(a) Relevanca

145. Lidhur me provat materiale të propozuara 233-264, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) strukturën dhe organizimin e UÇK-së, si dhe me praninë dhe operacionet e policisë ushtarake të UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut; (ii) organizimin hierarkik dhe mbajtjen e dokumentacionit në Brigadën 124; (iii) funksionimin e sistemit të ndalimeve në nivel brigade dhe kompetencat e policisë ushtarake të UÇK-së në lidhje me arrestimet dhe vendet e ndalimit; (iv) përfshirjen e anëtarëve të UÇK-së në krimet e kryera në Drenoc për të cilat u ngritën akuza; (v) ekzistencën e shtabit të Brigadës 124 në Reti në dimrin e vitit 1998/pranverën e vitit 1999; (vi) pushtetin që kishin Ismet Tara, Ejup Kabashi dhe komandantë të tjerë brenda komandës së UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut; (vii) kontrollin dhe pushtetin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në lidhje me çështjet civile në Zonën Operative të Pashtrikut; (viii) koordinimin e operacioneve në lidhje me ndalimin e civilëve dhe bashkëpunëtorëve të dyshuar; dhe (ix) shkeljen e marrëveshjes së demilitarizimit të UÇK-së. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 233, 237 dhe 250 janë formularë të ndryshëm standardë të UÇK-së; (ii) provat materiale të propozuara 234-236, 238-239, 246-249, 251, 259-260 dhe 263-264 janë vërtetime anëtarësie, formularë risistemimi në detyrë të anëtarëve, kalendarë të aktiviteteve të Brigadës 124 dhe biografi të ushtarëve të UÇK-së; ("personeli"); (iii) provat materiale të

propozuara 240-241, 243-245, 252-258 dhe 261-262²⁶⁷ janë rregullore të burgut ushtarak, urdhra dhe vendime të komandantëve të UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut ("dokumentet e komandës së UÇK-së"); dhe (iv) prova materiale e propozuar 242 është një videoincizim ku shfaqen anëtarë të Brigadës 124.

146. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar, ndër të tjera, se: (i) Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte dhe ushtronte pushtet në Zonën Operative të Pashtrikut, përfshirë përmes mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë, zbatimit të rregullave dhe rregulloreve dhe përcaktimit të strukturave të raportimit dhe komunikimit;²⁶⁸ (ii) komanda e Zonës Operative të Pashtrikut ishte në kontakt të rregullt me Shtabin e Përgjithshëm, bënte raporte dhe merrte urdhra, udhëzime dhe rregullore;²⁶⁹ (iii) në përputhje me urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm, komanda e Zonës Operative të Pashtrikut organizonte lëvizjet e hyrjes, daljes, dhe lëvizjet brenda Zonës Operative të Pashtrikut;²⁷⁰ (iv) komandantët e brigadave dhe batalioneve hartonin oraret e veprimtarive ditore të ushtarëve të tyre, mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët, armatimet dhe aktivitetin e tyre, lëshonin dokumente komunikimi të standardizuara, koordinoheshin me njësi të zonave operative të tjera, transferonin dhe kërkonin ushtarë dhe furnizime, dhe komunikonin rregullisht dhe drejtpërdrejt me komandën e Zonës Operative të Pashtrikut, dhe i raportonin Shtabit të Përgjithshëm e merrnin urdhra drejtpërdrejt prej tij;²⁷¹ dhe (v) policia ushtarake e UÇK-së ishte e përfshirë dhe përgjegjëse për identifikimin, arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të kundërshtarëve, përfshirë viktimat e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat në këtë çështje.²⁷²

²⁶⁷ Në lidhje me provën materiale të propozuar 262, Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja nuk kërkon pranimin si provë të f. SITF00439028 pasi ajo është pranuar si prova P01671.

²⁶⁸ Mocioni, para. 5.

²⁶⁹ Mocioni, para. 14.

²⁷⁰ Mocioni, para. 14.

²⁷¹ Mocioni, para. 18.

²⁷² Mocioni, para. 22.

147. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 233-264, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.²⁷³

(b) Autenticiteti

148. Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të provave materiale të propozuara 233, 237 dhe 250, që janë formularë të ndryshëm standardë të paplotësuar. Në veçanti, Trupi Gjykses vëren se këta formularë kanë fjalët Brigada 124 në krye, kanë vendet ku vihen data, nënshkrimi dhe numri i referencës, dhe në to përmenden veprimtari të përditshme të asaj kohe në Brigadën 124. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 250, e cila është një fletore shënimesh, përmban disa formularë standardë të paplotësuar dhe të plotësuar ku përfshihen data, nënshkrime, kanë emrin e UÇK-së në krye, dhe/ose në to përmenden komandantët përkatës të UÇK-së ose komandantët e Brigadës 124.

149. Në lidhje me dokumentet për personelin,²⁷⁴ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data;²⁷⁵ (ii) janë të nënshkruara;²⁷⁶ (iii) kanë vulën e UÇK-së;²⁷⁷ (iv) kanë emrin e UÇK-së në krye, me numra reference;²⁷⁸ dhe (v) përmendin ose kanë për autorë komandantë të njohur të UÇK-së.²⁷⁹ Kur provat materiale të propozuara përmbajnë lista ushtarësh, në to jepen edhe të dhënat personale të tyre.²⁸⁰ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 234-236, 238-239, 246-249, 251, 259-260 dhe 263-264 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

²⁷³ Aktakuza, para. 18-55; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 338-340. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

²⁷⁴ Provat materiale të propozuara 234, 235, 236, 238, 239, 246, 247, 248, 249, 251, 259, 260, 263, 264.

²⁷⁵ Provat materiale të propozuara 235, 238, 247, 248, 249, 251, 259, 260, 263, 264.

²⁷⁶ Provat materiale të propozuara 234, 235, 236, 238, 239, 247, 249, 251, 259, 260, 263, 264.

²⁷⁷ Provat materiale të propozuara 238, 239, 247, 251, 259, 260, 263, 264.

²⁷⁸ Provat materiale të propozuara 234, 235, 236, 238, 239, 246, 247, 248, 249, 251, 260, 263, 264.

²⁷⁹ Provat materiale të propozuara 234, 235, 236, 238, 239, 246, 247, 248, 249, 251, 259, 260, 263, 264.

²⁸⁰ Provat materiale të propozuara 246, 248.

150. Lidhur me dokumentet e komandës së UÇK-së,²⁸¹ Trupi Gjykues vëren se provat materiale të propozuara: (i) kanë data;²⁸² (ii) janë të nënshkruara;²⁸³ (iii) kanë vulën e UÇK-së;²⁸⁴ (iv) kanë në krye të dokumentit emrin e UÇK-së dhe të Brigadës 124, me numra reference;²⁸⁵ dhe (v) autorë të tyre janë komandantë të njohur të UÇK-së.²⁸⁶ Në lidhje me provën materiale të propozuar 240, Trupi Gjykues vëren se, ndonëse nuk është e nënshkruar dhe nuk ka datë, autor i saj është komandanti Gani Paçarizi dhe në dokument përmendet Brigada 124. Gjithashtu, në lidhje me provën materiale të propozuar 161, Trupi Gjykues thekson se në të përmenden fakte të përmendura edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykues ka bërë konstatim gjyqësor.²⁸⁷ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se provat materiale të propozuara 240-241, 243-245, 252-258 dhe 261-262 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

151. Lidhur me provën materiale të propozuar 242, Trupi Gjykues vëren se ajo është një videoincizim ku shfaqen anëtarë të Brigadës “Gani Paçarizi” (Brigada 124) gjatë një festimi. ZPS-ja parashtron se në videomaterial shihet duke folur Xhemë Gashi, ish-komandant i njësisë vendore të Drenocit. ZPS-ja parashtron se pozita e Xhemë Gashit si dhe anëtarësia në UÇK e dëshmorëve” të përmendur, konfirmohen nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes.²⁸⁸ Trupi Gjykues rikujton se, përgjithësisht, në mënyrë që videomaterialet të jenë të pranueshme si prova, nevojiten të dhëna për origjinën dhe integritetin e tyre.²⁸⁹ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vëren se videomateriali u shkarkua nga

²⁸¹ Provat materiale të propozuara 240, 241, 243, 244, 245, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 261, 262.

²⁸² Provat materiale të propozuara 241, 243, 244, 245, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 261, 262.

²⁸³ Provat materiale të propozuara 241, 243, 244, 245, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 261, 262.

²⁸⁴ Provat materiale të propozuara 241, 243, 244, 245, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 261, 262.

²⁸⁵ Provat materiale të propozuara 241, 243, 244, 245, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 261, 262.

²⁸⁶ Provat materiale të propozuara 240, 241, 243, 244, 245, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 261, 262.

²⁸⁷ Faktet e shqyrtuara 462, 463.

²⁸⁸ Shtojca 1 e Mocionit, f. 190, prova materiale e propozuar 242.

²⁸⁹ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 26.

YouTube prej TFHS-së dhe ZPS-ja ka dorëzuar transkriptin e plotë të përmbajtjes së tij. Trupi Gjykses thekson se videomaterialit i janë mbivendosur shënime, që pretendohet se përshkruajnë ngjarjet e incizuara. Trupi Gjykses konstaton se prova materiale e propozuar 242 është *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

152. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 233-264 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me fakte dhe rrethana relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 233-264 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

153. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 233-264 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

14. Provat materiale të propozuara 265-273: Brigada 125

(a) Relevanca

154. Në lidhje me provat materiale të propozuara 265-273, ZPS-ja parashton se ato lidhen me: (i) strukturën dhe organizimin e UÇK-së, që tregohet nga shpërndarja dhe lëshimi i dokumenteve të unifikuara të identifikimit; (ii) përgatitjen e ushtarëve të UÇK-së në kuadër të Brigadës 125, ndër të tjera, në fusha si gatishmëria luftarake; (iii) njohuritë që kishin në fillim të vitit 1999 njësitet e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut për formacionet dhe taktikat ushtarake; (iv) autoritetin e komandant Kabashit të batalionit të dytë, dhe ekzistencën e një sistemi mobilizimi për kryerjen e shërbimit ushtarak dhe masash për zbatimin e rekrutimit; dhe (v) strukturën operative dhe organizative të kompanisë së parë të batalionit të dytë në mars 1999. Në lidhje me to, Trupi

Gjykues vëren se: (i) provat materiale të propozuara 265 dhe 273 janë dokumente identifikimi të ushtarëve të Brigadës 125; (ii) prova materiale e propozuar 266 është një manual për këmbësorinë e UÇK-së, i përgatitur nga W04764; (iii) provat materiale të propozuara 267²⁹⁰ dhe 268²⁹¹ janë fletore më shënime me shkrim dore me autor Imer Muçajn në lidhje me, ndër të tjera, taktikat, formacionet, armatimet dhe pajisjet ushtarake; dhe (iv) provat materiale të propozuara 269-272 janë urdhra ditorë dhe për mobilizim të lëshuara nga Brigada 125.

155. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar, ndër të tjera, kursin e kryer në Nishor në shkurt 1999, ku komandantët e batalioneve morën leksione, ndër të tjera, për “luftën speciale” dhe “kolonën e pestë” të armikut, ku përfshiheshin informatorët dhe bashkëpunëtorët.²⁹²

156. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 265-273, Trupi Gjykues është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.²⁹³

(b) Autenticiteti

157. Në lidhje me autenticitetin e provave materiale të propozuara 265 dhe 273, Trupi Gjykues vëren se prova materiale e propozuar 265 është një dokument identifikimi me emblemën e UÇK-së, përmban një referencë për Brigadën 125, jepen të dhënat personale të individit të përmendur, dhe ka nënshkrim. Lidhur me provën materiale të propozuar 273, Trupi Gjykues vëren se lista e ushtarëve përmban të dhënat personale, gradat ushtarake, dhe datat e regjistrimit të individëve në të. Në lidhje me provën materiale të propozuar 266, Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja parashtrohet që ajo përmban shënime me shkrim dore dhe kopje të

²⁹⁰ Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja nuk kërkon pranimin si provë të f. U001-8825.

²⁹¹ Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja nuk kërkon pranimin si provë të f. U001-8838.

²⁹² Mocioni, para. 15.

²⁹³ Aktakuza, para. 18-55, Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 235. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

manualit të këmbësorisë së UÇK-së të përgatitura nga W04764. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse shënimet me shkrim dore nuk janë të nënshkruara, në dokument përmendet autori i tyre. Lidhur me provat materiale të propozuara 267 dhe 268, Trupi Gjykses vëren se ato janë shënime me shkrim dore që përshkruajnë me hollësi taktikat ushtarake të UÇK-së. Ty dy provat materiale të propozuara kanë data dhe janë të nënshkruara. Në lidhje me provat materiale të propozuara 269-271, Trupi Gjykses vëren se ato kanë data, janë të nënshkruara dhe kanë emrin e UÇK-së dhe numra reference në krye. Në lidhje me provën materiale të propozuar 272, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse dokumenti është me shkrim dore, ai ka datë dhe në të jepet një përmbledhje e detyrave ditore të togës së parë dhe të dytë. Trupi Gjykses thekson se provat materiale të propozuara 271 dhe 272 përkojnë edhe në përmbajtje. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 265-273 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

158. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 265-273 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 265-273 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

159. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 265-273 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

15. Provat materiale të propozuara 274-304: shërbimi i zbulimit/policia ushtarake/policia e MRP-së

(a) Relevanca

160. Lidhur me provat materiale të propozuara 274-304, ZPS-ja parashtron se ato lidhen me: (i) përbërjen dhe strukturën e policisë ushtarake të UÇK-së dhe njërive të saj në kuadër të brigadave; (ii) punën e policisë ushtarake të UÇK-së në Ratkoc nga fillimi i qershorit 1998 deri në qershor 1999; (iii) detyrat dhe përgjegjësitë e policisë ushtarake të UÇK-së, përfshirë arrestimet dhe ndalimet e civilëve dhe mbajtjen e disiplinës; (iv) strukturën dhe organizimin e UÇK-së, që tregohet nga shpërndarja dhe lëshimi i dokumenteve të unifikuara të identifikimit dhe i lejeve të udhëtimit për anëtarët e saj; (v) dijeninë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe komandës së zonës operative për keqtrajtimet dhe vrasjet e civilëve dhe praninë e tyre në terren, përfshirë në Kleçkë dhe rreth saj në prill 1999; (vi) pjesëmarrjen e anëtarëve të njësitit Çeliku 3 në ofensivën ushtarake në Llapushnik; dhe (vii) shkeljen e marrëveshjes së demilitarizimit nga UÇK-ja.²⁹⁴ Në lidhje me këto, Trupi Gjykses vëren se: (i) provat materiale të propozuara 274, 275, 281 dhe 285 përbëhen nga një ditar luftimesh dhe një fletore shënimesh ku përshkruhen veprimtari të UÇK-së dhe të një toge të policisë ushtarake të Brigadës 122 të UÇK-së; dokumente për pozicionimin e forcave serbe dhe ofensivat serbe kundër njësive të UÇK-së, dhe thirrje për mobilizim (“dokumentet për luftimet”); (ii) provat materiale të propozuara 276,²⁹⁵ 278, 286, 295, 297 dhe 301 përbëhen nga një përmbledhje dokumentesh që lidhen me raste të gjykuara nga gjykata ushtarake e UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut dhe/ose raste të hetuara nga

²⁹⁴ Shtojca 1 e Mocionit, f. 231-263, provat materiale të propozuara 274-304.

²⁹⁵ Në lidhje me provën materiale të propozuar 276, Trupi Gjykses vëren se pjesë të këtij dokumenti janë pranuar tashmë si prova: f. 082996-083001 si 2D00020/2D00020_ET; f. 082985-082985 si P00257/P00257_ET; f. 082984-082984 si P00260/P00260_ET; f. 083076-083076 si P00261/P00261_ET; f. 082934-082934 si P00264/P00264_ET; f. 082939-082983 si P00263/P00263_ET; f. 082926-082938, 082986, 082989-082993, 083002-083011, 083014-083015, 083017-083046, 083048-083050, 083052, 083055-083075, 083083, 083085-083086, 083087 si P02010/ P02010_ET.

policia ushtarake e UÇK-së, si dhe një fletarrestim (dokumentet e hetimeve të policisë ushtarake”); (iii) provat materiale të propozuara 277, 279, 282-284, 287-289, 291, 293-294, 296, 300 dhe 304 përfshijë dokumente identifikimi të policisë ushtarake të UÇK-së, të dhëna personale të anëtarëve të policisë ushtarake të UÇK-së, ndërrimet e shërbimit të rojës, deklarata të ushtarëve të UÇK-së në lidhje me sekuestrimin e armëve personale, dhe leje udhëtimi (“dokumentet për personelin”); (iv) provat materiale të propozuara 292 dhe 298 janë një ditar për praninë e policisë ushtarake të UÇK-së në Rahovec në vitin 1999; (v) prova materiale e propozuar 299 është një videomaterial ku shihet Hashim Thaçi; (vi) provat materiale të propozuara 290 dhe 302 janë letra të nënshkruara nga një zëvendëskomandant i UÇK-së; dhe (vii) prova materiale e propozuar 303 është një urdhër i lëshuar prej një zëvendëskomandanti të UÇK-së për kthimin e një arme.

161. Trupi Gjykues vëren më tej se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar, ndër të tjera, se: (i) Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte dhe ushtroi pushtet në Zonën Operative të Pashtrikut gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza, përfshirë përmes mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë;²⁹⁶ (ii) komandantët e brigadave dhe batalioneve mbanin evidenca të hollësishme për anëtarët, dhe për armatimin e aktivitetin e tyre;²⁹⁷ (iii) komandantët e brigadave dhe batalioneve paralajmëronin se për mosbindje ose moszbatim të urdhrave do të merreshin masa disiplinore;²⁹⁸ (iv) shërbimi i zbulimit dhe policia ushtarake ishin aktive në Zonën Operative të Pashtrikut të paktën nga vera e vitit 1998, përfshirë në vendet ku u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuzat;²⁹⁹ (v) policia ushtarake dhe shërbimi i zbulimit ekzistonin në nivelin e komandës së Zonës Operative të Pashtrikut dhe në nivel brigade;³⁰⁰ (vi) shërbimi i zbulimit dhe policia ushtarake vepronin shpesh së bashku dhe ishin të përfshira dhe përgjegjëse për

²⁹⁶ Mocioni, para. 5.

²⁹⁷ Mocioni, para. 18.

²⁹⁸ Mocioni, para. 18.

²⁹⁹ Mocioni, para. 20.

³⁰⁰ Mocioni, para. 21.

identifikimin, arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të kundërshtarëve, përfshirë viktimat e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat në këtë çështje;³⁰¹ dhe (vii) në fillim të vitit 1999, Shtabi i Përgjithshëm emëroi Nexhmi Krasniqin si komandant të policisë ushtarake të Zonës Operative të Pashtrikut.³⁰²

162. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 274-304, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.³⁰³

(b) Autenticiteti

163. Në lidhje me autenticitetin e dokumenteve për luftimet,³⁰⁴ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data,³⁰⁵ (ii) janë të nënshkruara,³⁰⁶ (iii) kanë emrin e autorit të dokumentit;³⁰⁷ (iv) kanë emrin e UÇK-së në krye dhe numra reference;³⁰⁸ (v) përmbajnë referenca për UÇK-në dhe/ose brigadat përkatëse, si Brigada 122;³⁰⁹ dhe (vi) në to përmenden veprimtari të asaj kohe të UÇK-së dhe/ose policisë ushtarake të UÇK-së gjatë veprimeve luftarake.³¹⁰ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara 274 dhe 281 përmbajnë fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.³¹¹ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 274, 275, 281 dhe 285 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

³⁰¹ Mocioni, para. 22.

³⁰² Mocioni, para. 21.

³⁰³ Aktakuza, para. 18-55, 78; Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 338-342, 617, 636. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

³⁰⁴ Provat materiale të propozuara 274, 275, 281, 285.

³⁰⁵ Provat materiale të propozuara 274, 275, 281.

³⁰⁶ Provat materiale të propozuara 274, 281, 285.

³⁰⁷ Provat materiale të propozuara 274, 275, 281, 285.

³⁰⁸ Prova materiale e propozuar 281.

³⁰⁹ Provat materiale të propozuara 274, 275, 281, 285.

³¹⁰ Provat materiale të propozuara 274, 275, 281, 285.

³¹¹ Faktet e shqyrtuara 264, 269, 462.

164. Në lidhje me dokumentet e hetimeve të policisë ushtarake,³¹² Trupi Gjykses verën se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data;³¹³ (ii) janë të nënshkruara;³¹⁴ (iii) kanë emrin e autorit të dokumentit³¹⁵ dhe emrin e UÇK-së në krye si dhe numra reference;³¹⁶ dhe (iv) në to ka referenca për UÇK-në dhe/ose brigadat përkatëse, si Brigada 122.³¹⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 295 përmban fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor³¹⁸ dhe se shumica e këtyre provave materiale të propozuara kanë për autor komandantë të njohur të UÇK-së. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 276, 278, 286, 295, 297 dhe 301 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

165. Në lidhje me dokumentet për personelin,³¹⁹ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) janë të nënshkruara;³²⁰ (ii) kanë data;³²¹ (iii) kanë emrin e UÇK-së në krye dhe/ose emblema e numra reference;³²² (iv) janë në formularë zyrtarë standardë të UÇK-së;³²³ dhe (v) kur provat materiale të propozuara janë lista të anëtarëve të UÇK-së, në to jepen të dhënat personale të tyre.³²⁴ Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se, në thelb, provat materiale të propozuara 282, 283 dhe 293 përkojnë me njëra-tjetrën. Lidhur me provën materiale të propozuar 304, Trupi Gjykses vëren se ndonëse nuk është e nënshkruar dhe nuk ka datë, anëtarësia në UÇK e individëve të renditur në të konfirmohet nga prova të tjera të pranuar në

³¹² Provat materiale të propozuara 276, 278, 286, 295, 297, 301.

³¹³ Provat materiale të propozuara 276, 278, 286, 295, 297, 301.

³¹⁴ Provat materiale të propozuara 276, 278, 286, 295, 297, 301.

³¹⁵ Provat materiale të propozuara 276, 278, 286, 295, 297, 301.

³¹⁶ Provat materiale të propozuara 278, 295, 297, 301.

³¹⁷ Provat materiale të propozuara 276, 278, 286, 295, 297, 301.

³¹⁸ Fakti i shqyrtuar 462.

³¹⁹ Provat materiale të propozuara 277, 279, 282, 283, 284, 287, 288, 289, 291, 293, 294, 296, 300.

³²⁰ Provat materiale të propozuara 277, 279, 282, 283, 287, 288, 289, 291, 293, 294, 296, 300.

³²¹ Provat materiale të propozuara 277, 279, 282, 283, 287, 288, 289, 291, 293, 294, 296, 300.

³²² Provat materiale të propozuara 277, 279, 287, 288, 289, 291, 294, 296.

³²³ Provat materiale të propozuara 277, 282, 283, 289, 293.

³²⁴ Provat materiale të propozuara 282, 283, 288, 293.

dokumentacionin e çështjes, si dhe nga W03885.³²⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 288 përmban fakte që përmenden edhe në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.³²⁶ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 277, 279, 282-284, 287-289, 291, 293-294, 296, 300 dhe 304 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

166. Në lidhje me provat materiale të propozuara 292 dhe 298, Trupi Gjykses vëren se ato përbëhen nga shënime me shkrim dore që kanë për autor komandantët përkatëse të UÇK-së. Të dyja provat materiale të propozuara kanë data dhe nënshkrime në dokumente, dhe prova materiale e propozuar 292 ka edhe disa vula të kuvendit komunal të Rahovecit të QPK-së. Lidhur me provat materiale të propozuara 290, 302 dhe 303, Trupi Gjykses vëren se ato kanë të gjitha për autor një zëvendëskomandant të UÇK-së dhe janë nënshkruar prej tij, kanë datë dhe emrin e UÇK-së në krye, si dhe numra reference. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 290, 292, 298, 302 dhe 303 kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

167. Në lidhje me provën materiale të propozuar 299, Trupi Gjykses vëren se përbëhet nga një videomaterial nga *Associated Press* ku tregohet Hashim Thaçi dhe të tjerë në Rahovec, në një ceremoni përkujtimore për ushtarët e rënë në betejë.³²⁷ Trupi Gjykses rikujton se, përgjithësisht, në mënyrë që videomaterialet të jenë të pranueshme si prova, nevojiten të dhëna për origjinën dhe integritetin e tyre.³²⁸ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja informon se videomateriali u shkarkua nga *YouTube* dhe se ajo ka dorëzuar transkriptin e plotë të përmbajtjes së tij. Trupi Gjykses vëren se videomateriali ka simbolin e televizionit të *Associated*

³²⁵ *Shih* Transkriptin e seancës, 23 shtator 2024, f. 20137, rreshtat 9-15 deri në f. 20138, rreshtat 6-11; P01670.

³²⁶ Fakti i shqyrtuar 262.

³²⁷ Shtojca 1 e Mocionit, f. 258, 259.

³²⁸ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 26.

Press dhe përshkruan ngjarjet që pretendohet se janë videoincizuar. Krahas kësaj, autenticiteti i këtij videomateriali konfirmohet më tej nga prova të përfshira në Mocion dhe të pranuar prej Trupit Gjykses.³²⁹ Gjithashtu, videomateriali lidhet me fakte të përmendura në faktet e shqyrtuara në procese të tjera, për të cilat Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor.³³⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se prova materiale e propozuar 299 është *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

168. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 274-304 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e provave materiale të propozuara 274-304 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

169. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 274-304 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).

16. Provat materiale të propozuara 305-316

(a) Relevanca

170. Lidhur me provat materiale të propozuara 305-316, ZPS-ja parashton se ato lidhen me: (i) kontrollin, menaxhimin dhe administrimin e trupave në Zonën Operative të Pashtrikut; (ii) strukturën e UÇK-së, përfshirë atë të njësive speciale që pretendohet se morën pjesë në rrëmbime, sulme, ndalime dhe vrasje të civilëve, si dhe ekzistencën e një politike të UÇK-së ndaj bashkëpunëtorëve të dyshuar; (iii)

³²⁹ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, prova materiale të propozuar 298. *Shih gjithashtu* paragrafin 158 më lart.

³³⁰ Faktet e shqyrtuara 74, 76-78.

drejtimin e shtabeve dhe kryerjen e hetimeve prej UÇK-së; (iv) kryerjen e trajnimeve prej anëtarëve të lartë të UÇK-së; (v) funksionimin e Brigadave 123, 124 dhe 125, si dhe të njësisë speciale “Syri i Shqiponjës” në Zonën Operative të Pashtrikut; dhe (vi) komandën dhe kontrollin që ushtronte UÇK-ja/QPK-ja në zonat operative në maj 1999. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 305, 308, 309, 310, 311 dhe 315 janë certifikata të ushtarëve në Zonën Operative të Pashtrikut, orare të shërbimit dhe të ndërrimit të rojave, fletore me shënime për oraret trajnimi, detyra të ushtarëve të UÇK-së dhe evidenca të lejeve të dhëna; (ii) prova materiale e propozuar 306 përmban shënime me shkrim dore për listën e organeve ekzekutive në shtabin vendor të UÇK-së; (iii) prova materiale e propozuar 307 është një shënim me shkrim dore në lidhje me viktimën e një vrasjeje; (iv) provat materiale të propozuara 312,³³¹ 313 dhe 314 janë shënime me shkrim dore në lidhje me strategjinë ushtarake, raporte ushtarake, kode thirrjesh dhe komunikimi, informacion mbi ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe një raport i UÇK-së mbi situatën; dhe (v) prova materiale e propozuar 316 përmban një listë personash të dyshuar, përfshirë emrat e disa prej viktimave të përmendura në Aktakuzë.³³²

171. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në këto prova materiale të propozuara për të treguar, ndër të tjera: (i) se shërbimet e zbulimit dhe policia ushtarake shpesh vepronin së bashku dhe ishin të përfshira rregullisht dhe përgjegjëse për identifikimin, arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të kundërshtarëve, përfshirë viktimat e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat në këtë çështje;³³³ (ii) përbërjen e shtabit të komandës së Zonës Operative të Pashtrikut;³³⁴ (iii) se komandantët e brigadave dhe batalioneve trajnonin oficerët në përputhje me urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm;³³⁵ dhe (iv) se disa njësi speciale

³³¹ Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja kërkon të paraqesë për pranim vetëm f. U003-1681-U003-1740.

³³² Shtojca 1 e Mocionit, f. 264-275, provat materiale të propozuara 305-316.

³³³ Mocioni, para. 22.

³³⁴ Mocioni, para. 13.

³³⁵ Mocioni, para. 18.

i raportonin drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm, ndër to edhe njësia “Syri i Shqiponjës” e komanduar nga Nezir Kryeziu.³³⁶

172. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 305-316, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha bashkë lidhen me fakte dhe rrethana që janë relevante për akuzat e përfshira në Aktakuzë.³³⁷

(b) Autenticiteti

173. Në lidhje me dokumentet për personelin,³³⁸ Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë data;³³⁹ (ii) janë të nënshkruara ose kanë emrin e autorit të dokumentit;³⁴⁰ (iii) kanë emrin e UÇK-së në krye dhe numra reference;³⁴¹ dhe/ose (iv) përmendin UÇK-në.³⁴² Gjithashtu, në këto prova materiale të propozuara përmenden aktivitetet ditore të ushtarëve të UÇK-së në atë kohë, në periudha të ndryshme të vitit 1998, si dhe emrat e ushtarëve përkatës.³⁴³ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet për personelin kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe janë *prima facie* autentike.

174. Në lidhje me provën materiale të propozuar 306, Trupi Gjykses vëren se ndonëse e panënshkruar dhe pa datë, në të përmendet shtabi vendor i UÇK-së dhe jepen pozitat e ndryshme në organin ekzekutiv të shtabit vendor të UÇK-së. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se prova materiale e propozuar 306 ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti dhe është *prima facie* autentike.

175. Në lidhje me provën materiale të propozuar 312, Trupi Gjykses vëren se ajo titullohet “Dokumentacion i UÇK-së,” dhe informacioni në të ka datë dhe i referohet komandantëve të njohur të UÇK-së, ndër ta dhe Bislim Zyrapit. Prova

³³⁶ Mocioni, para. 23.

³³⁷ Aktakuza, para. 18-55. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet ndaj R.1.

³³⁸ Provat materiale të propozuara 305, 308, 309, 310, 311, 315.

³³⁹ Provat materiale të propozuara 305, 308, 309, 311, 315.

³⁴⁰ Provat materiale të propozuara 305, 308, 310.

³⁴¹ Prova materiale e propozuar 305.

³⁴² Provat materiale të propozuara 305, 308, 309, 310, 311, 315.

³⁴³ Provat materiale të propozuara 305, 308, 315.

materiale e propozuar 313 ka datë, është informacion për aktivitete të armatosura të UÇK-së në vitin 1999, si lëvizjet e brigadave, dhe lista të anëtarëve të brigadave të ndryshme të UÇK-së me të dhënat personale të tyre. Gjithashtu, prova materiale e propozuar 314 ka datë dhe është e nënshkruar, në të ka referenca për aktivitetet e UÇK-së dhe brigadave aktive në zonat operative të UÇK-së. Në lidhje me provën materiale të propozuar 316, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse e panënshkruar dhe pa datë, emrat e individëve në listë janë konfirmuar edhe nga prova të tjera të pranuar në dokumentacionin e çështjes.³⁴⁴ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se disa prej individëve të përmendur janë edhe në listën e viktimave të pretenduara në Aktakuzë.³⁴⁵

176. Në lidhje me provën materiale të propozuar 307, Trupi Gjykses vëren se ajo është një shënim me shkrim dore pa nënshkrim dhe, ndonëse ka datë dhe referencë për “shtabin”, Trupi Gjykses gjykon se nga informacioni aty nuk është e qartë nëse individët e përmendur kishin lidhje me UÇK-në. Trupi Gjykses vëren se, ndonëse ZPS-ja parashtrohet se informacioni në dokumente të paraqitura më parë për pranim konfirmon vrasjen e përshkruar në provën materiale të propozuar 307, Trupi Gjykses nuk mundi ta gjejë atë informacion në dokumentet e përmendura.³⁴⁶ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses nuk është bindur se ZPS-ja ka demonstruar autenticitetin *prima facie* të provës materiale të propozuar 307.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

177. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 305-306 dhe 308-316 janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese

³⁴⁴ *Shih* P00993.2_ET.

³⁴⁵ *Krahaso* provën materiale të propozuar 316, materialin nr. 68 dhe Aktakuzën, para. 162.

³⁴⁶ Shtojca 1 e Mocionit, f. 265, prova materiale e propozuar 307.

prima facie e provave materiale të propozuara 305-306 dhe 308-316 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve.

(d) Përfundim

178. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 305-306 dhe 308-316 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1) dhe refuzon, në formë jo të prerë, pranimin e provës materiale të propozuar 307.

V. KLASIFIKIMI

179. Trupi Gjykses thekson se Përgjigjja u dorëzua si konfidenciale në përputhje me rregullën 82(4).³⁴⁷ Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen të kërkojë riklasifikimin ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes brenda 7 ditësh nga lëshimi i këtij Vendimi. Trupi Gjykses gjithashtu udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë Kundërpërgjigjen nga konfidenciale në publike brenda 3 ditësh nga lëshimi i këtij Vendimi.

180. Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative që t'u caktojë materialeve të pranuar klasifikimin e treguar në Shtojcën 1 të Mocionit.

VI. VENDIM

181. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** pjesërisht Mocionin;
- b) **PRANON** si prova këto materiale të propozuara për pranim dhe përkthimet e tyre: 1-30, 32-64, 66-107, 109-121, 123-129, 131-145, 147-166, 168, 170-205, 207-230, 232-306 dhe 308-316;
- c) **REFUZON**, në formë jo të prerë, pranimin e provave materiale të

³⁴⁷ Përgjigjja, para. 9.

propozuara 31, 65, 108, 122 dhe 307;

- d) **UDHËZON** Zyrën Administrative të pasqyrojë statusin e provave P01804 MFI, P02078 MFI dhe P01123 MFI si të pranuar;
- e) **E DEKLARON** të tejkalar kërkesën për pranimin e provave materiale të propozuara 130, 146, 167, 169, 206 dhe 231;
- f) **AUTORIZON** ZPS-në të zëvendësojë përkthimin e paraqitur në Mocion për provën materiale të propozuar 155 me përkthimin e rishikuar të saj;
- g) **UDHËZON** Zyrën Administrative t'u caktojë materialeve të pranuar: (i) numra prove; dhe (ii) klasifikimin e treguar në Shtojcën 1 të Mocionit;
- h) **UDHËZON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike Kundërpërgjigjen brenda 3 ditësh nga lëshimi i këtij Vendimi; dhe
- i) **UDHËZON** Mbrojtjen të kërkojë riklasifikimin e Përgjigjes ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të saj brenda 7 ditësh nga lëshimi i këtij Vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith III

Kryegjykatës

E martë, 1 prill 2025

Në Hagë, Holandë.